

1 E premte, 16 maj 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Seanca e apelit]

4 [Apeluesi hyn në sallën e gjyqit përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 10.00

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

8 Mirëmëngjes, të gjithëve.

9 Z. Sekretar, thërrisni lëndën, ju lutem.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju faleminderit.

11 Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BA-
12 2024-03, Prokurori Specializuar kundër Pjetër Shalës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Konstatoj, si dihej, që z. Shala nuk është i pranishëm
16 fizikisht në sallën e gjyqit por që merr pjesë përmes
17 videolidhjes.

18 Tani do t'u kërkoj palëve që të prezantohen, duke filluar
19 me avokatin e z. Shala.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jemi i njëjti ekip
21 siç ishim dje. Siç e thatë edhe ju, z. Shala merr pjesë përmes
22 videolidhjes. Jemi këtu z. Aouini, znj. Cariolou, znj.
23 Petravica, znj. Ulpiana, znj. Mustafai dhe unë vetë, z.
24 Gilissen.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani Zyra e Prokurorit.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. ZPS-ja
4 përfaqësohet nga Kimberly West, Prokurorja e Specializuar,
5 Maria Wong, Line Pedersen, Max Karakul, Sarah Clanton dhe unë
6 vetë, Filippo De Minicis.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Tani Mbrojtësi i Viktimave.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Simon Laws,
11 Mbrojtësi i Viktimave në këtë çështje bashkë me
12 bashkëmbrojtësen time Maria Radziejowska.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Vazhdojmë sot me seancën e apelit lidhur me z. Shala,
16 apel i parashtruar kundër aktgjykimit të Trupit Gjykses të
17 datës 16 korrik 2024. Do të vazhdojmë si në vijim: Programi i
18 punës është ndryshuar pak me qëllim që t'ju japim kohë të
19 mjaftueshme palëve të trajtojnë pyetjet dhe t'u përgjigjen
20 pyetjeve të parashtruara nga Trupi Gjykses.

21 Së pari do të dëgjojmë parashtrimet e fundit të ZPS-së
22 lidhur me Pikën 14 për përcaktimin e dënimit, pastaj
23 përgjigjet ndaj pyetjeve të parashtruara nga Trupi Gjykses, 50
24 minuta. Pra, deri në 10.50 e gjitha kjo. Pastaj do të dëgjojmë
25 përgjigjen e Mbrojtësit të Viktimave deri në 11.50. Nga 11.50

1 do marrim 20 minuta pushim deri në 12.10. Pastaj, Mbrojtësi i
2 z. Shala do të ketë 40 minuta për kundërpërgjigjen e tij edhe
3 për parashtrimet e tij të fundit dhe gjithashtu për t'u
4 përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga Trupi Gjykses. Pastaj
5 do t'i japim z. Shala dhjetë minuta nga ora 12.50 deri në 1.00
6 për t'u shprehur.

7 Tani do të dëgjojmë avokatin e ZPS-së. Ju keni kohë deri
8 në 10.50, 50 minuta.

9 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
10 Gjykatës.

11 Lidhur me Pikën 14 të apelit, neve na u kërkua të japim
12 pikëpamjen tonë, qëndrimin tonë lidhur me aktgjykimin e
13 Gjykatës Kushtetuese të datës 17 prill 2025 nëse kjo ndikon në
14 konstatimet e Trupit Gjykses.

15 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ndikon në
16 konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me përcaktimin e dënimit
17 për z. Shala. Ajo që ne konfirmojmë dhe përforcojmë është që
18 është saktësia e përcaktimit të dënimit të Trupit Gjykses dhe
19 analiza e saj.

20 Në aktgjykimin e tij, Gjykata e saj, Dhoma e Gjykatës
21 Kushtetuese qartësoi disa kritere për përcaktimin e dënimit.
22 Në veçanti, ajo mbështeti dhe konfirmoi konstatimet e
23 mëparshme të Panelit të Apelit që parimi i ligjit më të butë
24 zbatohet vetëm për ligjet që janë detyruese për DHSK-në, Dhoma
25 e Gjykatës Kushtetuese ripërcaktoi dhe qartësoi këtë parim të

1 rëndësishëm. Konstatimet dhe përcaktimet e Dhomës së Gjykatës
2 Kushtetuese janë detyruese për gjyqësorin dhe gjithë personat
3 dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

4 Kjo është gjuha e thjeshtë e nenit 116(1) i Kushtetutës.

5 Për kundër asaj që pretendohet në Pikën 14 të dosjes së
6 apelit, Trupi Gjykses nuk ka gabuar në interpretimin e
7 kriterëve ligjore të Nenit 44(2)(a) dhe (b). Trupi Gjykses
8 mori parasysh siç duhet ligjin në kohën e kryerjes së veprave
9 penale dhe ligjin më të butë që vinte më pas. Ai konstatoi që
10 ligjet e mëpasshme që ishin, që u miratuan pas kryerjes së
11 veprave penale ishin ose të barabarta ose dhe më të ashpra
12 sesa ligji që ishte në fuqi në kohën relevante.

13 Ai mori parasysh burimet e ligjit relevant dhe parimet e
14 tjera që merren parasysh në përcaktimin e dënimit përpara se
15 të arrinte në përcaktimin e dënimit të duhur e cila pasqyron
16 peshën e rëndë të krimeve dhe totalitetin, tërësinë e sjelljes
17 kriminale të apeluesit.

18 Dje, avokatja e apeluesit deklaroi se Trupi Gjykses ka
19 gabuar në zbatimin e ligjit në kohën -- duke moszbatuar ligjin
20 relevant me kohën, ligjin në fuqi në kohën relevante. Ky është
21 argument ndryshe nga ai që është bërë në dosjen e apelit dhe
22 do ta trajtoj këtë duke thënë që është ligj i përcaktuar që
23 ligji vendor për përcaktimin e dënimit nuk është detyrues për
24 DHSK-në. Dhoma e Gjykatës Kushtetuese dhe Dhoma e Gjykatës
25 Supreme, Paneli i Apelit dhe Trupi Gjykses në çështjen Mustafa

1 dhe Shala e kanë konfirmuar këtë të gjitha.

2 Për vendime të mëparshme të Panelit të Apelit kanë
3 konstatuar se zbatimi i ligjit të DHSK-së nuk është, nuk cenon
4 parimin e ligjshmërisë. Ju referoj juve tek parashtrimi F10 i
5 datës 11 shkurt 2022, paragrafi 24-31. I njëjti në të njëjtin
6 vendim Paneli i Apelit konfirmoi vendimin e Gjykatës të
7 Procedurës Paraprake lidhur me parashikueshmërinë dhe
8 qasshmërinë e NKP-së në z. Shala.

9 Përkundër asaj që është thënë dje, ishe e parashikueshme
10 që z. Shala mund të dënohej në vitin 1999 siç është e qartë që
11 ai mund të dënohej. Pra, arsyet përfshijnë ato që gjenden në
12 paragrafin 36 të parashtrimit F10.

13 Ndërsa megjithëse shkalla e përcaktimit të dënimit nuk
14 është e përcaktuar në ligjin ndërkombëtar zakonor, gjykatat e
15 tjera kanë konstatuar se nuk mund të ketë dyshime se krimet e
16 luftës si pjesë e krimeve më të rënda i nënshtrohen ndëshkimit
17 me burg dhe për to parashihihen dënime të rënda. Të nderuar
18 Gjykatës, ju referohem këtu në aktgjykimin e apelit në rastin
19 Mladic, paragrafi 564 dhe Celibici 817.

20 Shkurtimisht, ZPS-ja konstaton dhe vë në dukje se
21 qartësimet në vijim nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, 17
22 prill 2025 dhe parimet në vijim që udhëheqin, pra, mbi të
23 cilat bazohet përcaktimi i dënimit. Së pari, ligji vendor për
24 përcaktimin e dënimit janë detyrues, ligjet vendore janë
25 detyruese për këtë gjykatë. Pastaj, ligji më i butë, lex

1 *mitior* nuk zbatohet për Nenin 44, në lidhje me Nenin 44(2).

2 Së dyti, për analizën e Nenit 44(2)(a) shkalla e dënimit
3 bashkëkohore është nga Kodi Penal i ish-Jugosllavisë e vitit
4 1976. Ky është përfundimi i Panelit, i Trupit Gjykues në -- i
5 Panelit në aktgjykimin e apelit në çështjen Mustafa.

6 Për më tepër, kjo është çështje përpara TPNJ-së, që është
7 TPNJ-a, pra, në mënyrë të vazhdueshme ka konstatuar se nuk
8 është detyruar nga, pra, nuk është detyruar të ndjekë
9 praktikat në përcaktimin e dënimit të ish-Jugosllavisë duke
10 konstatuar se Kodi Penal i ish-Jugosllavisë 1976 ishte
11 relevant për ligjin vendor. Ju referoj tek poshtëshënimi 291 i
12 aktgjykimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese.

13 Së treti, shkalla e përcaktimit të dënimit apo dënimi për
14 Nenin 44(2)(5) qëllimet e kësaj gjenden në poshtëshënimin 2190
15 të aktgjykimit të cilat janë identike me ato të konstatuara
16 në poshtëshënimin 1284 për në apelin e Mustafës edhe pse
17 asnjëri prej tyre nuk është më i butë sesa Kodi Penal i 1976 i
18 ish-Jugosllavisë i ndryshuar nga rregullorja e UNMIK-ut
19 1999/24 dhe ligji nuk parasheh dënim minimal.

20 Praktikat e përcaktimit të dënimit të lidhura me ligjin
21 me të drejtën vendore, shkalla e këtij dënimi janë gjithashtu
22 marrë -- duhet të merren parasysh dhe kjo është bërë në
23 paragrafin 1070 të aktgjykimit. Dhe, në fund, dua të
24 konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese mbështeti
25 deklaratat e ligjit nga Paneli i Apelit duke përfshirë siç

1 është konstatuar në apelin e parë të Mustafës më 14 dhjetor
2 2023. Konkretisht, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese u pajtua
3 me deklaratat e ligjit të Panelit të Apelit duke përfshirë
4 këtu aktgjykimin e apelit të Mustafës dhe duke thënë që kjo
5 është në kundërshtim me vendimin mbi ligjshmërinë të Dhomës së
6 Gjykatës Kushtetuese.

7 Lidhur me këtë ZPS-ja konstaton se Paneli dhe Trupi
8 Gjykues në çështjen Shala ka pasqyruar analizën e aktgjykimit
9 të apelit në çështjen Mustafa të 14 dhjetorit 2023. Nuk janë
10 bërë gabime të mëtejshme në ligjshmëri, në vendimin e
11 ligjshmërisë së Gjykatës Supreme apo në vendimin për
12 ripërcaktimin e dënimit që duhet të jenë detyruese apo dhe
13 bindëse për këtë Panel të Apelit. Duke ndjekur, për shembull,
14 vendimin e ripërcaktimit të dënimit në çështjen Mustafa dhe
15 kjo thjesht do të vazhdonte më tej, do çonte më tej gabimin që
16 është konstatuar që buron nga një analizë e pasaktë e ligjit
17 të zbatueshëm nga Dhoma e Gjykatës Kushtetuese e kësaj.

18 Mbrojtja dhe kundërshtoi gjithashtu saktësinë e
19 deklaratës së z. Shala bazuar në faktorët e tjerë përfshirë
20 dënimet e personave të tjerë dhe rrethanat prej të akuzuarve.
21 Ky kundërshtim duhet të hidhet poshtë sepse dënimi i caktuar
22 ka qenë proporcional dhe sepse Shala nuk identifikon gabim të
23 qartë në analizën e Trupi Gjykues. Pjesa dërmuese e çështjeve
24 të ngritura e çështjeve të ngritura dhe, pjesa më e madhe në
25 çështje të ngritura dhe janë trajtuar në paragrafin 262, 268

1 të dosjes së përgjigjes. Nuk do t'i përsërisë ato.

2 Dënimi në këtë rast është përcaktuar duke pasur parasysh
3 faktorë e kërkuar që janë pesha e rëndë, pasojat e krimeve,
4 kontributi i dhënë nga i akuzuari, rrethanat personale të të
5 akuzuarit dhe për faktorë të tjerë që kam përmendur,
6 ekzistenca e faktorëve zbutës dhe rëndues.

7 Gjykuesi i fakteve ka patur prerogativë apo kompetencë të
8 gjerë për të peshuar faktorët relevantë dhe përcaktuar
9 dënimin.

10 Në analizën e dënimit Trupi Gjykues në mënyrë të gjerë ka
11 përshkruar peshën e rëndë të krimeve dhe vuajtjen e viktimave
12 nga këto krime. Arriti në përfundimin se pesha e rëndë e
13 krimeve dhe pasojat kanë qenë të larta dhe të mëdha. Më tej ka
14 vlerësuar se pjesëmarrja personale e z. Shala, pjesëmarrjen e
15 z. Shala duke konstatuar rolin e tij aktiv dhe keqtrajtimin
16 personal nga ai të viktimave dhe konstatoi nivelin e lartë të
17 pjesëmarrjes dhe nivelin e lartë të qëllimit, synimit kriminal
18 penal.

19 Trupi Gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat
20 relevante, përfshirë rolin e formal jokomandues, pra, mungesën
21 e rolit komandues të z. Shala. Trupi Gjykues konsideroi, mori
22 parasysh parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me rrethanat
23 personale të akuzuarit. Trupi Gjykues shpjegoi se asnjë prej
24 këtyre rrethanave nuk përlligjë një ulje të dënimit në këtë
25 çështje.

Trupi Gjykses dha arsye të hollësishme për përfundimet e tij. Duke pranuar vështirësitë që lidhen me konfliktin që ka përjetuar i akuzuari, Trupi Gjykses konstatoi se mund t'i jepte pak peshë e pak rëndësi faktorëve që lidhen me këto vështirësi dhe si të tilla këto nuk justifikojnë, nuk përlligjin, pra, një ulje të dënimit. Komentet e Avokatit Mbrojtës dje se Trupi Gjykses nuk e ka individualizuar dënimin apo për ta thënë ndryshe nuk i ka marrë parasysh rrethanat individuale të apeluesit, nuk marrin parasysh analizën që është bërë në paragrafin 1109, 1118 të aktgjykimit.

Këto konstatime, siç e kam thënë më herët, shpjegojnë dhe mbështesin dënimin e përcaktuar. Trupi Gjykses arriti në përfundimin se ishte e duhur dhe me vend që të lëshohej vendimi për një periudhë kohore të gjatë, një dënim i gjatë pra. Pra, dënimi i përcaktuar është brenda ushtrimit të duhur të Trupit Gjykses të kompetencave, ushtrimit të kompetencave të tij. Dënimi i z. Shala nuk i afrohet fare dënimit maksimal, pra, që është dënimi me burgim të përjetshëm. Ndërsa e drejta vendore dhe ligji vendor, shkalla e dënimit në këtë është e detyrueshme dhe duke marrë -- nuk është detyruese marrja parasysh e shkallës së dënimit vendore në të dyja këto, pra, koha dhe pas, efekti, ligji në atë kohë dhe ligji i mëpasshëm, është e vërtetë që ligjet e Kosovës japin mundësinë për një dënim shumë më të gjatë sesa 18 vjet.

Është e rëndësishme të konstatohet se Trupi Gjykses

1 kishte, pati të drejtën që të vendosë, që të caktojë dhe
2 kishte mundësi që të jepte një dënim dhe më të rëndë ose më të
3 ulët sesa ai që parashikohet nga ligjet vendore, sipas Nenit
4 44(1).

5 Duke u përgjigjur ankesës se z. Mustafa, përkundër z.
6 Shala, kishte autoritet dhe përgjegjësi dhe ka marrë një dënim
7 dhe më të ulët se z. Shala, është e rëndësishme të rikujtohet
8 të rikujtohet dallimi mes këtyre çështjeve, përfshirë edhe sa
9 i takon dënimit për vrasje. Në rastin e Mustafës, Trupi
10 Gjykues konstatoi se z. Mustafa ishte përgjegjës bazuar ndër
11 të tjera dhe në pjesëmarrjen e tij personale dhe keqtrajtimin
12 me vdekje provuar se cili është konstatimi, është konstatuar
13 që ishte synimi i tij. Ky ishte aktgjykimi dhe pjesa, kjo
14 gjendet në paragrafin 745, 818.

15 Mustafa nuk është dënuar për kryerjen e vrasjes në mënyrë
16 fizike dhe personale. Kjo është krejt një skaner faktik krejt
17 ndryshe nga ai që është konstatuar që ka ndodhur me vrasjen në
18 rastin tonë në fjalë. Në këtë rast z. Shala ka qenë i
19 pranishëm dhe ka marrë pjesë në rrahjet jashtëzakonisht
20 brutale të viktimës së vrasjes. Roli i tij ka qenë i
21 drejtpërdrejtë, i qëllimtë dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë.
22 Mënyra e pjesëmarrjes e zbuluar ka zbuluar vendosmërinë e z.
23 Shala për të vrarë viktimën e vrasjes.

24 Provat e siguruara nga të ndaluarit, që u përmendën dje,
25 gjendja e rëndë e viktimës heqin, mënjanojnë çdo argument që

1 z. Shala nuk e dinte që viktima e vrasjes ishte në gjendje të
2 rëndë në momentin në fjalë, në momentin në kohën kritike. Ky i
3 ndaluar ishte qëlluar [REDAKTUAR]
4 [REDAKTUAR] pastaj ishte rrahur dhe pas kësaj kishte vdekur
5 për shkak të plagëve. Trupi Gjykues përshkroi agoninë si
6 faktor rëndues.

7 Ne nuk po sugjerojmë se sjellja e z. Mustafa ishte më pak
8 e fajshme, më pak mizore, është e rëndësishme të rikujtojmë
9 këtu se z. Shala, atë që z. Shala i ka bërë viktimës së
10 vrasjes dhe viktimave të tjera në këtë çështje kur i është
11 dhënë mundësia ta bëjë këtë. Dënimi 15-vjetor i z. Mustafa për
12 të cilin u bë apel, i cili u përmend dhe të cilin e përmendi
13 si ankesë Avokati i z. Shala ka një rezultat në vendimin mbi
14 ligjshmërinë të gjithë Dhomës së Gjykatës supreme të cilën
15 Dhoma e Gjykatës Kushtetuese e ka tani përcaktuar që ishte
16 bazuar në një interpretim të gabuar të ligjit. Për rrjedhojë,
17 nuk është i dobishëm apo e sigurtë që të përdoret si burim
18 krahasimi.

19 Pjesë e arsyes së Panelit të Apelit për reduktimin e
20 zvogëlimin e dënimit të z. Mustafa ka qenë edhe identifikimi i
21 shkallës së përcaktimit të dënimit nga Dhoma e Gjykatës
22 Supreme i cili ishte i gabuar. Baza ligjore për Dhomën e
23 Gjykatës, për vendimin e ligjshmërisë së Dhomës së Gjykatës
24 Supreme dhe ripërcaktimi, vendimi për ripërcaktimin e dënimit
25 të mëvonshëm përmbanin gabime ligjore të cilat nuk duhet të

1 ripërsëritet apo të ndikojnë në analizën e saktë të Trupit
2 Gjykues në çështjen Shala.

3 Kjo është deklaruar më parë por është e nevojshme që të
4 ripërmendet se krahasimet e dënimeve dhe përpjekjet për të
5 transpozuar këto përcaktime dhe konstatime të njëjtë nga një
6 Trupi Gjykues tek një tjetër, janë të rrezikshme dhe pse mund
7 të jenë gjëra që nuk mund të bëhen dhe janë, nuk mund të
8 krijohen përputhshmëri dhe secili dënim është unik dhe ka
9 karakteristikat e veçanta të saj. Kjo është e përcaktuar dhe
10 konfirmuar dhe nga Dhoma e Apelit të TPNJ-së në apel nga Apeli
11 i Panelit dhe ky Apel i Panelit në çështjen, në aktgjykimin e
12 çështjes Mustafa. Ju referoj tek paragrafi 266 i përgjigjes
13 tonë.

14 Konstatova më parë faktorët rëndues të konstatuar nga
15 Trupi Gjykues që ishte agonia, agonia e zgjatur dhe e vdekjes
16 së vrasjes së viktimës së vrasjes. Trupi Gjykues konstatoi dy
17 faktorë të tjerë rëndues: Kryerja e krimit me mizori të
18 veçantë dhe të ashpër, që lidhet me agoninë e viktimës së
19 vrasjes, gjithashtu dhe kryerja e krimeve kundër personave që
20 ishin të cënueshëm dhe të pambrojtur.

21 Trupi Gjykues konstatoi gjithashtu mizorinë e përdorur në
22 veçanti lidhur me vrasjen që është treguar dhe nga gjendja
23 mendore e tmerrshme të cilën kanë vuajtur viktimat. Ky ishte
24 paragrafi 1097 i aktgjykimit.

25 Në të gjithë këto aspekte, jo vetëm vrasja, provat në

1 dosjen e lëndës tregojnë brutalitetin e ashpër dhe të qartë të
2 ndalimit, keqtrajtimit si pjesëmarrje e vullnetshme si dhe
3 pjesëmarrjen që është konstatuar në paragrafin 655 të
4 aktgjykimit duke qeshur dhe buzëqeshur gjatë kohës që po
5 rrihnin të ndaluarit. Kjo gjendet në paragrafin 1106 të
6 aktgjykimit, ka qenë i parë që e ka goditur atë dhe është
7 gjetur, pra, është konstatuar që ai ndante synimin kriminal të
8 përbashkët. Dënimi i Shalës është një pasqyrim i drejtë dhe i
9 duhur i peshës së rëndë të krimeve dhe rolit e tij në kryerjen
10 e tyre.

11 Tani do të doja të kaloja tek pyetjet që kanë -- pyetjet
12 vijuese.

13 Dje, pyetja e parë që u përgjigjën është a ka element që
14 faktik në mënyrë faktuale dallojnë çështjet e TPNJ-së të
15 cilëve u referuat nga faktet e kësaj çështjeje dhe provat,
16 pra, provat e marra nga personat e ndaluar mund të mos jenë
17 konkluzive, pra, përfundimtare për standardet relevante? Dhe
18 kjo vjen nga parashtrimet që kam bërë lidhur me jurisprudencën
19 e tribunaleve, gjykatave të tjera që mbështesin provat se
20 Trupi Gjykses mund të marrë parasysh për t'u bindur se nuk
21 kishte arsye që shqetësimet e sigurisë që i përlligjnin
22 mbajtjen në ndalim, përfshirë dhe këto përfshijnë provat që
23 vijnë nga persona vetë të ndaluar.

24 Siç e thashë dje, mbështetja në provat e të ndaluarve
25 është konstatuar në shumë aktgjykime të tjera, përfshirë edhe

1 ato që përmenden në çështjen Delalic në çështjen e apelit.

2 Për t'u përgjigjur pyetjes tuaj, ka dallime faktike mes
3 çështjeve që lidhen me vendndodhjen, shkallën, llojin e
4 kryerësve, kohëzgjatjen e operacioneve në kampe, për të
5 përmendur vetëm disa prej tyre. Megjithatë, fakti që ka
6 dallime faktike në tiparet faktike në rastet e ndryshme që
7 janë qenë përmendur nuk do të thotë që provat e të ndaluarve
8 vetë duhet të merren parasysh në mënyrë të ndryshme apo të
9 shqyrtohen në mënyrë të ndryshme apo të konsiderohen si me më
10 pak vlerë provuese apo përcaktuese sepse dallimet faktuale --
11 sesa dallimet faktuale apo dallimet në rastet e tjera.

12 Provat e të ndaluarve që kanë dhënë në këtë çështje janë
13 prova të drejtpërdrejta dhe për çështje të ndryshme të
14 rëndësishme. Së pari, ato japin prova të drejtpërdrejta se
15 kush ishin ata përpara kësaj përvoje, përpara se të
16 ndaloheshin. Ata japin prova të drejtpërdrejta për rrethanat
17 që ishin menjëherë përpara që të fillonte ndalimi i tyre dhe
18 shpjegimi është dhënë për këtë dhe heqja e lirisë së tyre.
19 Shumë të ndaluar japin prova të drejtpërdrejta, dëshmi të
20 drejtpërdrejta lidhur me pretendimet që janë ngritur kundër
21 tyre përfshirë hollësitë mbi vendndodhjen, pretendimet që janë
22 bërë.

23 Provat e pranuar duhet të përmbushin kriteret e
24 rregullës 138. Pas kësaj, në këtë çështje, Trupi Gjykses e
25 bëri një vlerësim të gjerë dhe të hollësishëm të besueshmërisë

1 së këtyre dëshmitarëve. I referohem aktgjykimit paragrafi 71,
2 96, 283. Trupi Gjykues konstatoi se deklaratat e të ndaluarve
3 lidhur me arrestimin e tyre, objektin e ndalimit, kushtet e
4 ndalimit, praninë dhe keqtrajtimin e të ndaluarve të tjerë,
5 rolin e pjesëtarëve të UÇK-së janë mbështetur në gjerësi dhe
6 në mënyrë të bollshme nga dëshmi dhe deklaratat, përfshirë
7 edhe raportet e ekspertëve dhe të tjerë. I referohem këtu
8 aktgjykimit dhe paragrafëve 103, 123, 130, 140, 166, 180.

9 Dhe duhet të përmendet se në aktgjykimin e Trupit Gjykues
10 konstatohet përputhshmëria e deklaratave të dëshmitarëve
11 lidhur me natyrën e pyetjeve që iu janë bërë atyre. Kjo
12 gjendet në paragrafin 590.

13 Më tej parashtrimet për besueshmërinë e dëshmitarëve mund
14 të gjenden në paragrafët 54, 101 të dosjes tonë.

15 Për të përfunduar në përgjigje të pyetjes tuaj të parë,
16 dua t'i kthehem diçkaje që e thashë dje. Përmenda gjykimin e
17 apelit në çështjen Delalic i cili mbështeti qasjen e
18 aktgjykimit në çështjen tonë. Fjalët konkrete në aktgjykim
19 janë se pas marrjes së dëshmisë nga të ndaluarit, Dhoma e
20 Trupit Gjykues mund të pranonte provën, dëshminë e tyre, pra,
21 të këtyre të ndaluarve.

22 Pas dëgjimit të gjithë hollësive nga individët e ndaluar
23 në këtë çështje, Trupi Gjykues mund të arrijë tek përfundimet
24 lidhur me natyrën e operacionit të ndalimit dhe të arrinte në
25 përfundime se të ndaluarit nuk janë ndaluar mbi bazën e

1 arsyeve serioze dhe legjitime që lidhen me çështje apo
2 shqetësime të sigurisë. Ky përfundim i Trupit Gjykses duhet të
3 mbështet, konfirmohet përveç në rast se të vërtetohen nga
4 gjykuesi i fakteve -- përveç në rastet se gjykuesi i fakteve
5 nuk jep arsye të vlefshme për këtë.

6 Me lejen tuaj tani do të kalojë tek pyetja e dytë.

7 Gjykatësi Ambos pyeti: Nëse palët mund të bëjnë komente
8 lidhur me provat në dosjen e lëndës që nuk vijnë nga personat
9 e ndaluar që janë relevante për konstatimet e Trupit Gjykses
10 paragrafi 947 dhe të ndaluarit që nuk janë mbajtur të ndaluar
11 në FMK sipas akuzave penale dhe që nuk kishte shqetësime të
12 sigurisë që e bëjnë absolutisht të domosdoshme mbajtjen e tyre
13 të ndaluar?

14 Lidhur me përveç provave të të ndaluare, provat e
15 pjesëtarëve të familjeve mbështesin konstatimet se disa të
16 ndaluar nuk janë ndaluar për arsye legjitime apo të rënda që
17 mbështesin, që do të mbështesnin ndonjë shqetësim sigurie
18 konkrete apo të rëndë. Tani, lidhur janë disa aspekte tek
19 provat e tyre që të kalojmë.

20 Të kalojmë në seancë private.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Kalojmë në
22 seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

20 jemi në seancë publike.

21 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Pyetjet e bëra prej jush,

22 anëtarë të Trupit Gjykses, ngrenë një çështje shumë të

23 rëndësishme për t'u përmendur. Në fakt të ndaluarit janë

24 mbajtur në fabrikën e metalit në Kukës në maj dhe në qershor

25 1999. Kjo gjendet në aktgjykim. Po ashtu ka shumë dëshmi të

1 cilat janë marrë gjatë gjykimit që përshkruajnë ambientet e
2 fabrikës së metalit në Kukës, gjithashtu dhe pjesë të tjera të
3 fabrikës.

4 Po ashtu faktet e gjykuara 51, 53 dhe 55 përshkruajnë
5 ndryshimin e ambienteve dhe konfirmojnë gjithashtu dhe
6 ndalimin e nëntë persona të ndaluar. Ndoshta mund të duket
7 prozaike që të përmenden këto fakte të gjykuara, megjithatë,
8 të gjithë me përjashtim të një rasti anëtarë të UÇK-së të
9 pranishëm në Kukës kanë mohuar se kanë njohuri lidhur me
10 ndërtesën e ndalimit apo me ndalimin e të ndaluarve.

11 Dje, gjatë komenteve hapëse, kolegu im, tha shkurtimisht
12 sesi anëtarë të UÇK-së të cilët kanë punuar në fabrika e
13 metalit në Kukës, përfshirë dhe ata të cilët kanë dhënë dëshmi
14 për palën mbrojtëse, nuk janë të besueshëm për çështje faktike
15 të thjeshta si, për shembull, për sa i takon pranisë së një
16 ambienti, një godine qendrore në oborr të kompleksit. Si
17 shpjegim në hollësi në përgjigjen tonë sa i takon pikës 10 në
18 paragrafin 188 deri në 196, ne kemi parashtruar se shumë prej
19 këtyre dëshmitarëve kanë punuar në këtë godinë, në këtë
20 ndërtesë në portën e saj për muaj të tjerë. Ata kanë provuar
21 që kanë qenë të pagatshëm për të pranuar fakte bazë dhe duke
22 mos folur këtu për gjëra të tjera të cilat janë më domethënëse
23 sa i takon të ndaluarve.

24 Ju lutem, a mund të kalojmë në seancë private?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Na kaloni

1 në seancë private, Sekretar.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 jemi në seancë publike. Faleminderit.

1 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] E përmenda këtë dëshmitar dhe
2 anëtarë të tjerë të UÇK-së, të nderuar Gjykatës, për të
3 shpjeguar që, në këtë çështje gjyqësore, anëtarë të UÇK-së, të
4 cilët ishin persona të tjerë të pranishëm në fabrikë, në një
5 bazë ushtarake, kanë provuar apo kanë dëshmuar tërësisht që
6 nuk kanë qenë të gatshëm që të japin llogari apo të japin
7 dëshmi të plota sa i takon gjithë gjërave që ata kanë parë
8 lidhur me ndalimin. Trupi Gjykues nuk mund të mbështetej në
9 dëshminë e personave të tjerë përveç personave të ndaluar dhe
10 familjarëve të tyre për të përcaktuar shqetësimet e sigurisë
11 që mund të kenë ekzistuar sepse ata që kanë pasur njohuri për
12 sa i takon regjimit të ndalimit kanë mohuar që kanë pasur
13 ndonjë njohuri ose dijeni sa i takon fakteve bazë të këtij
14 ambienti.

15 Tani, për të përfunduar, dua t'u referohem paragrafëve 96
16 dhe 97 të aktgjykimit. Në këtë pjesë Trupi Gjykues ka
17 konstatuar se ka pasur një klimë të vazhdueshme frike dhe
18 frikësimi në Kosovë që zbatohet gjithashtu edhe për
19 dëshmitarët dhe që po ashtu mund të zbatohet edhe mbi
20 dëshmitarët potencialë dhe familjarët e tyre dhe në kontekstin
21 më të gjerë zbatohet dhe në persona të tjerë të cilët mund të
22 japin dëshmi për krime që pretendohen të kenë ndodhur dhe të
23 jenë realizuar nga anëtarë të UÇK-së. Trupi Gjykues përshkruan
24 "ndikimin e dukshëm" të këtij faktori mbi dëshmitarë të
25 caktuar. Ky faktor gjithashtu mund të jetë një ndër më

1 përcaktuesit sa i takon ndikimit negativ që mund të nxirret sa
2 i takon burimit të dëshmive dhe provave të dhëna.

3 Tani do të kaloj tek një pyetje tjetër.

4 Pra, është pyetja e tretë e Gjykatësit Ambos, është një
5 pyetje hipotetike. Pra, pyetja është kjo:

6 "Në një situatë të një konflikti të armatosur të ngjashëm
7 me këtë situatë për të cilën po flasim, a nuk është e
8 mendueshme ose e përfytyrueshme që një palë e një konflikti
9 mendon që pala tjetër përdorë persona për të spiunuar? Kështu
10 që në këtë situatë të përgjithshme për juve a është një
11 situatë e mendueshme ose e mundur që në një konflikt të
12 ngjashëm, pra, një konflikt të armatosur një person mund të
13 mendojë, ndoshta edhe gabimisht, që një person tjetër nga pala
14 tjetër mund të jetë një spiun? Pra, është një pyetje
15 hipotetike, në qoftë se ky skenar është i mundur, a mund të
16 ndodhë që të kemi një gabim faktik ose që mund të lidhet me
17 situatën?".

18 Mendoj që kjo është një pyetje e përbërë, pra, përbëhet
19 prej dy pyetjeve të veçanta.

20 Së pari, po, është e mendueshme që anëtarët e një pale në
21 një konflikt të armatosur mund të mendojnë që pala tjetër mund
22 të përdorë persona për t'i spiunuar ata. Dje unë përmenda
23 faktin që spiunazhi dhe sabotimi mund të jenë situata të cilat
24 përbëjnë shqetësime për sigurinë të cilët mund të justifikojnë
25 deri diku ndalimin.

1 Së dyti, është po ashtu e mendueshme që një person
2 gabimisht të mendojë që një person i ndaluar nga pala tjetër
3 të mund të jetë një spiun. Megjithatë, ka pjesë të këtij
4 skenari, sikurse janë shpjeguar dhe të paktën ashtu siç e kam
5 kuptuar unë nga pyetja e bërë, të cilat janë shumë të ndryshme
6 nga çështja për të cilën ne po diskutojmë. Atëherë në qoftë se
7 më lejoni do të thoja që së pari në pyetje thuhet në mënyrë të
8 tërthortë që personat mund të jenë spiunë ose në mënyrë të
9 gabuar mund të konsiderohen si të tillë si të dyshuar.

10 Megjithatë në rastin në fjalë nuk kemi dëshmi, nuk kemi prova
11 që të mendojmë që të ndaluarit kanë qenë pjesë e palës armike
12 ose palës opozitare. Ata nuk kanë qenë luftëtarë dhe nuk kanë
13 qenë as ushtarë profesionist më përpara.

14 Të ndaluarit kanë qenë thjesht persona të zakonshëm.

15 Këtë dua që t'jua përmend si rezultat i dallimit faktik
16 ndërmjet skenarit që sugjerohet nga pyetja e Gjykatësit dhe
17 fakteve të çështjes përkatëse, jurisprudenca tregon se në
18 qoftë se një person në moshë për të qenë ushtar ose që
19 pretendohet që të mbështetë ose t'i përkasësh një grupi ose që
20 të kesh pikëpamje politike të ngjashme nuk është një bazë e
21 përshtatshme për të konstatuar që një individ përbën shqetësim
22 për sigurinë. Kjo në fakt është e vërtetuar dhe e konstatuar
23 në gjykimin kundër Delalic në paragrafin 567, 576 dhe 577.

24 Po ashtu është e pamjaftueshme për të pasur kompetencën
25 për të ndaluar një civil vetëm fakti që ti ke dyshime për këto

1 persona që në qoftë se janë të lirë, pra, në qoftë se janë
2 duke jetuar lirisht, ata teorikisht ata mund të jenë të
3 spiunë.

4 Të ndaluarit nuk janë informuar për pretendimet se janë
5 spiunë. Pra, në qoftë se i pyet njerëzit që në qoftë se janë
6 miq me serbët ose në qoftë se kanë ndonjë marrëdhënie me
7 serbët, kjo në vetvete nuk është se provon se bëhej fjalë për
8 pretendime spiunazhi ndaj tyre. Në qoftë se ti thua, e pranon
9 që ke një marrëdhënie shoqërore me një person pavarësisht nga
10 prejardhja etnike e personit kjo nuk përcakton profilin e
11 sigurisë së tij ose të saj.

12 Faktet e kësaj e çështjeje nuk mbështesin konstatimin që
13 vendimi për ndalimin pa ekzistencën e shqetësimit për sigurinë
14 në nivelin e nevojshëm ka qenë gabim. Kjo tregohet vetë nga të
15 ndaluarit, nga rrethanat e tyre personale po gjithashtu dhe
16 nga numri i të ndaluarve nga rrethanat e tyre dhe nga
17 vagullsia e pretendimeve të cilat janë ngritur ndaj tyre.

18 Mund të bëhen gabime por gabimet duhet që të jenë të
19 bazuara në informacion legjitim dhe serioz. Duke marrë
20 parasysh sfondin dhe historikun e shumë prej këtyre të
21 ndaluarve, është e pabesueshme që ata të jenë komandantë serbë
22 ose ndryshe të jenë përfshirë në aktivitete që përbënin
23 kërcënime serioze për aktivitetet e asaj kohe ose të ardhshme
24 të UÇK-së.

25 Sa i takon vlerësimit fillestar, keqtrajtimi pasues i të

1 ndaluarve dhe mohimi i garancive procedurale bazike e bën
2 ndalimin e tyre të paligjshëm.

3 E di se e zgjata pak më tepër. Do ju kërkoja dhe pesë
4 minuta tjera në qoftë se do jetë e mundur, pasi kam edhe një
5 pikë tjetër për të ngritur.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do jetë e
7 vështirë sepse kemi pak kohë në dispozicion, kemi dhe palë të
8 tjera për të dëgjuar. Kështu që do ju kërkoja që të
9 përfundonit në kohën që ju kemi caktuar paraprakisht.

10 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Shkurtimisht do thoja që edhe në
11 qoftë se vendimi fillestar për të ndaluar është i ligjshëm,
12 pala ndaluese ka detyrimin që të vërtetojë që rrethanat
13 personale të individit në fjalë kërkojnë që personi të mbahet
14 në ndalim.

15 Të nderuar Gjykatës, dua që t'ju referoj në aktgjykimin e
16 Delalic ku ka një diskutim sa i takon kohëzgjatjes së
17 arsyeshme për ndalimin e një personi, po ashtu dua t'ju tërheq
18 vëmendjen tek konstatimet përkatëse që duhet të ketë një kohë
19 minimale të nevojshme dhe çfarë përbën kohë të arsyeshme nuk
20 është diçka që vlerësohet vetëm në kompetencën e palës
21 ndaluese.

22 Faktet tregojnë që disa prej të ndaluarve janë mbajtur
23 për disa javë. Ata janë rrahur kur nuk kanë pranuar që t'i
24 përgjigjen pyetjeve. Janë detyruar gjithashtu që të këndojnë
25 këngë serbe. Por asnjë nga këto fakte nuk tregojnë që ka pasur

1 një hetim në kohën minimale të nevojshme. Këto fakte nuk
2 mbështesin konstatimin që në qoftë se ka pasur një gabim të
3 mundshëm legjitim, ai është zgjidhur në përputhje me mbrojtjet
4 në dispozicion të personave që kanë bërë ndalimin.

5 Faleminderit. Ky ishte fundi i parashtrimeve të mia.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

7 Faleminderit ju.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Tani unë do t'i
9 përgjigjem pyetjeve që u bënë nga Gjykatësi Ambos dhe nga
10 Gjykatësja Jorgensen. Kanë mbetur dhe tetë minuta. Do ju
11 kërkoja dy minuta shtesë në mënyrë të tillë që të kem dhjetë
12 minuta në dispozicion.

13 Gjykatës Ambos, dje, ju pyetët për NKP-në, në fakt pyetja
14 për NKP-në kishte të bënte me tre pjesë. Pjesa e parë kishte
15 të bënte me faktin në qoftë se ne prezumojmë që vrasja e
16 personit të ndaluar ishte pjesë e NKP-së ose vrasja e personit
17 që ka qenë atje ka qenë pjesë e NKP-së. Dhe qëndrimi ynë është
18 që ne e konfirmojmë këtë. Ne mendojmë që vrasja është pjesë e
19 NKP-së siç përshkruhet në aktgjykim në paragrafët 1016 deri në
20 1023.

21 Pjesa e dytë e pyetjes tuaj ka të bëjë me synimin,
22 domethënë, në qoftë se ka ekzistuar një synim i NKP-së në
23 raport me krimet e përfshira në qëllimin e përbashkët dhe juve
24 pyetët: Në qoftë se është kështu, synimi që kërkohet për
25 vrasjen specifike a është i njëjti synim i përgjithshëm që ka

1 të bëjë me NKP-në?

2 Përgjigja që kemi ne për këtë pyetje është kjo: Synimi sa
3 i takon qëllimit të përbashkët dhe të asaj që kërkohet për
4 krimet që bëjnë pjesë të qëllimit të përbashkët janë të
5 njëjtat, domethënë, është *mens rea* e krimeve që përfshihen në
6 qëllimin e përbashkët dhe kjo *mens rea* është e njëjtë me *mens*
7 *rea* që kërkohet nga anëtarët e NKP-së. Sipas parashtrimit tonë
8 këto janë përfundime të cilat dalin nga interpretimi i
9 jurisprudencës të cilat kërkojnë që secili prej anëtarëve të
10 NKP-së duhet që të ketë synimin për krijimin e planit që janë
11 pjesë e planit të përbashkët. Për shembull, këtë mund ta gjeni
12 në aktgjykimin e Brdjanin dhe gjithashtu edhe në aktgjykimin e
13 apelit në çështjen Stanisić, paragrafi në çështjen e parë
14 është 430 dhe në të dytin 77. Kjo po ashtu rrjedhë nga kërkesa
15 që anëtarët e NKP-së duhet që të kenë synimin për sa i takon
16 kryesve kryesorë. Këtë mund ta gjeni më konkretisht në
17 çështjen Kvocka në aktgjykimin e apelit në paragrafin 110, ku
18 bëhet dallimi midis kryesve kryesorë dhe anëtarëve të NKP-së.

19 Kërkesa që plani i përbashkët të përfshijë kryerjen e
20 krimeve me synim të posaçëm, atëherë anëtarët e NKP-së duhet
21 që të kenë synimin e veçantë për të kryer këto krime dhe sipas
22 parashtrimit tonë kjo konfirmon më tej ekuivalencën me *mens*
23 *rea*, domethënë, që *mens rea* në të dyja rastet është e njëjtë.

24 Po ashtu jurisprudenca në këto raste është konsistente,
25 në të thuhet që plani i përbashkët mund të rrjedhë ose mund të

1 nënkuptohet nga një sërë personash të cilët veprojnë në unison
2 me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që ta vënë në jetë një
3 plan të tillë. Më konkretisht, kjo jepet në aktgjykimin e
4 apelit Tadic në paragrafin 227 dhe në aktgjykimin e apelit
5 Brdjanin në paragrafin 430.

6 Në këtë çështje, Trupi Gjykses në mënyrë të saktë
7 përcaktoi që vrasja si pjesë e planit të përbashkët mbi bazën
8 e veprimeve dhe deklaratave të anëtarëve të NKP-së. Gjithsesi
9 mund t'i referoheni përmbledhjeve dhe këto janë konstatime që
10 mund t'i gjeni në paragrafët 1016 deri në 1019. Këto veprime,
11 për shembull, përfshijnë faktin që kryesit me 4 qershor 1999,
12 kanë vazhduar që të keqtrajtojnë viktimën e vrasjes së
13 paligjshme pavarësisht faktit që ai po rridhte gjak si
14 rezultat i plagës nga arma e zjarrit. Kjo jepet në paragrafin
15 1016 të aktgjykimit.

16 Kjo provë, po ashtu, në mënyrë të saktë, sipas mendimit
17 tonë, është mbështetur në faktin që z. Shala ka pasur *mens rea*
18 e nevojshme për vrasjen. Kjo mund të gjendet në paragrafin
19 1034 të aktgjykimit. Kjo është një demonstrim i mëtejshëm i
20 faktit që kemi të bëjmë me një mbivendosje ndërmjet synimit të
21 përgjithshëm dhe qëllimit të përbashkët si dhe *mens rea* e
22 krimeve si pjesë e NKP-së.

23 Atëherë, tani do të kalojmë tek një pikë tjetër, bëhet
24 fjalë për një çështje tjetër të lloji i *mens rea* që kërkohet
25 për sa i takon një krimi të vetëm në ndjekje të qëllimit të

1 përbashkët konfirmojnë që anëtarët e NKP-së duhet të kenë *mens*
2 *rea* që kërkohet për krime të tilla. Për referencë kjo mund të
3 gjendet në aktgjykimin e apelit në çështjen 002/19-09-
4 2007/ECC/SC data është 23 nëntor 2016, ndërkohë që më
5 konkretisht paragrafët përkatës janë 1054 deri në 1055.

6 Për shembull, sa i takon vrasjes, kërkesa *mens rea*, që
7 është përcaktuar në këtë vendim apeli, është përcaktuar në të
8 dyja rastet, domethënë, në rastet kur të akuzuarit kanë pasur
9 synim të drejtpërdrejtë por gjithashtu edhe në rastet kur të
10 akuzuarit kanë pasur informacion për gjasa thelbësore që
11 vrasja mund të kryhej për të çuar më tej objektivin e
12 përbashkët.

13 Në këtë çështje, domethënë, në çështjen kundër z. Shala,
14 Paneli ka konstatuar që anëtarët e NKP-së kanë pasur qëllim të
15 përbashkët për të ndaluar në mënyrë arbitrare, për të marrë në
16 pyetje, për të torturuar dhe për të vrarë të ndaluar në
17 fabrika e metalit në Kukës të cilët janë perceptuar se kanë
18 bashkëpunuar, kanë qenë të lidhur ose që kanë pasur simpati me
19 autoritetet serbe ose që janë konsideruar si jo mjaftueshëm
20 mbështetës ndaj përpjekjeve të UÇK-së. Kjo gjendet në
21 paragrafin 1024.

22 Në këtë rast, ne mund të vlerësojmë si përkufizim që
23 ekziston qëllimi i përbashkët, kështu që analiza e qëllimit të
24 përbashkët, *mens rea* edhe pjesa e krimeve për sa i takon
25 qëllimit të përbashkët janë të njëjtat gjëra, domethënë, kemi

1 mbivendosje të tyre me njëra-tjetrën.

2 Dua të përfundoj me një koment duke iu përgjigjur asaj
3 çfarë tha Mbrojtja dje. Mbrojtja argumentoi që ekziston nevoja
4 që anëtarët e NKP-së, për shembull, në rastin e një vrasjeje,
5 pra, është e nevojshme që të ekzistojë synimi për kryerjen e
6 kësaj. Në përgjigje të këtij pretendimi të Mbrojtjes, ne themi
7 që nuk ka një kërkesë të tillë, pra, nuk ka kërkesë që
8 anëtarët e NKP-së të kenë synim të përbashkët për kryer
9 manifestimin e caktuar të ndonjë krimi, në rastin në fjalë të
10 vrasjes. Pra, sipas nesh, kjo është e dukshme edhe nga rrëzimi
11 i aktgjykimit të apelit të Brdjanin sa i takon propozimit që
12 lidhur me përgjegjësinë penale për NKP-në, pra, për të pasur
13 një përgjegjësi penale lidhur me NKP-në, duhet të ketë një
14 marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave për kryerjen e
15 një krimi brenda statutit të tyre. Më konkretisht, këtë mund
16 ta gjeni në paragrafin 390 të aktgjykimit të apelit të
17 Brdjanin.

18 Tani do të kaloj tek pjesa e fundit e pyetjes tuaj,
19 Gjykatës, e kjo ka të bëjë me mënyrën se si e kuptojmë ne
20 synimin e tërthortë.

21 Sipas parashtrimit tonë dhe për qëllime të këtij
22 diskutimi, synimi i tërthortë është synimi i cili përshkruhet
23 në argumentin e dytë ose në pjesën e dytë të përkufizimit të
24 *mens rea* për vrasje, përkufizim ky që është përdorur nga Trupi
25 Gjykses në paragrafin 987 të aktgjykimit të apelit, të

1 aktgjykimit. Është synimi i tërthortë në rastin kur kryesi,
2 për shembull, në mënyrë të arsyeshme mund të kishte ditur që
3 ekziston një lëndim i rëndë trupor ose për të dhënë një tjetër
4 shembull mund të ekzistojë kur kemi të bëjmë me mohimin e
5 kujdesit shëndetësor. Sa i takon referencave. Referencat mund
6 të jenë aktgjykimi i Karadzic, në paragrafin 449, aktgjykimi i
7 Stakic, në paragrafin 587, 616 ose aktgjykimi i Perisic në
8 paragrafin 104. Të gjitha çështjet që përmenda janë çështje të
9 TPNJ-së.

10 Gjendja mendore përmbush kërkesën *mens rea* për vrasjen
11 dhe kjo është përcaktuar dhe në këto aktgjykime. Megjithatë në
12 këto aktgjykime nuk jepet në mënyrë të shprehur dallimi midis
13 synimit të tërthortë dhe synimit të drejtpërdrejtë, domethënë,
14 thjesht bëhet përshkrimi i *mens rea* por nuk thuhet që kemi të
15 bëjmë me *mens rea* të tërthortë apo të drejtpërdrejtë, për
16 shembull, në rastin Akayesu të ICTR-së. Dhe dua t'ju tërheq
17 vëmendjen në aktgjykimin e kësaj çështjeje, në paragrafin 589.

18 Kam përfunduar me përgjigjet e pyetjeve tuaja, të nderuar
19 Gjykatës, në qoftë se keni ndonjë pyetje tjetër ju lutem na i
20 bëni.

21 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit shumë. Dua të
22 sqaroj diçka. Apo argumentoni që ekziston synimi i dyfishtë?
23 Ajo çfarë nuk kuptoj unë me synim të dyfishtë është si më
24 poshtë. Ti ke një synim për sa i takon synimit të përbashkët,
25 domethënë, je anëtar i NKP-së dhe duhet të kesh gjendjen

1 mendore për të pasur synim. Kjo është pjesa e parë.

2 Së dyti, mund të kesh gjithashtu edhe synim dytësor për
3 sa i takon, për shembull, veprës penale të dytë. Me sa kuptova
4 unë ju pajtoheni me këtë që unë e quaj ndryshe synim të
5 dyfishtë. Por ndërkohë sa i takon pjesës së dytë nuk e kam
6 shumë të qartë, jam pak sa i ngatërruar, i paqartë lidhur me
7 atë çfarë thatë, kështu që dua që të ma sqaroni, në rastin
8 tuaj si e kuptoni ju, në qoftë se kemi të bëjmë me një NKP I,
9 me rastin e NKP-së I, si në rastin konkret siç është parë kjo
10 nga aktgjykimi që përfshinë edhe një vrasje, kjo në vetvete
11 dhe si anëtar i NKP-së do të thotë kjo që keni një qëllim të
12 përbashkët dhe *mens rea*, pra, kjo në vetvete ju e mendoni që
13 është e mjaftueshme që të ngarkojmë me përgjegjësi penale dikë
14 për vrasjen e dikujt, domethënë, kjo jo domosdoshmërisht kërkon
15 pasjen e një synimi konkret.

16 Domethënë, kemi të bëjmë me dy synime apo me NKP I, ju
17 mendoni që përfshihet dhe vrasja siç presumohet këtu
18 mbështetur në aktgjykim, mund të na e sqaroni këtë sepse sa i
19 përket vrasjes specifike nuk duhet që të kesh një synim të
20 veçantë po synimi duhet që të parashikohet apo që të përmbahet
21 në këtë synimin e përgjithshëm që ka të bëjë me NKP I?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit që më dhatë
23 mundësinë që ta sqaroj.

24 Së pari, në këtë rast, synimi apo fakti që z. Shala ka
25 pasur synimin për të kryer një krim si anëtar i NKP-së rrjedhë

1 nga fakti që ai ka synimin për të vrarë këtë person specifik.

2 Domethënë, në këtë kuptim ka mbivendosje.

3 Sa i takon dualitetit të kërkesën, domethënë, në qoftë se
4 ekziston kërkesa që të provohet synimi për qëllimin e
5 përbashkët dhe krimet e përfshira, pra, synimi për krimet e
6 përfshira në qëllimin e përbashkët, kjo varet rast pas rasti,
7 domethënë, varet sesi bëhet formulimi i qëllimit të
8 përbashkët. Për shembull, në qoftë se qëllimi i përbashkët
9 përfshin diçka që jo nuk është kriminale, nuk penale në
10 thelbin e vetë.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Tani nuk është e nevojshme që
12 të jemi teorikë. Po flasim për këtë rast. Po fillojmë me
13 prezumimet sepse juve sapo na referuat te paragrafi 1024 ku në
14 aktgjykim thotë që synimi i përbashkët përfshinë vrasjen.

15 Le të fillojmë nga këtu. Le ta mendojmë kështu. Le të
16 mendojmë që unë jam anëtar i NKP I. Duke qenë anëtar i NKP I,
17 që përfshin dhe vrasjen kjo prezumon që synimi im shkon në
18 drejtim të vrasjes, megjithëse nuk provohet synimi im për
19 vrasje. Domethënë, i takon që unë nuk kam synim specifik por
20 është synim i përgjithshëm. Nuk e di, më ndiqni në këtë çfarë
21 po them, Prokuror, apo jo, mbase nuk jam shumë i qartë? Ky
22 është problemi, këtë doja që të na sqaroni.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, ju ndjek. Megjithatë do ju
24 kërkoja një çast nëse mundeni.

25 Të nderuar Gjykatës, në këtë çështje gjyqësore bëhet

1 fjalë për të njëjtin synim. Në një çështje më të madhe mbase
2 mendimi mund të ishte ndryshe, interpretimi mund të ishte
3 ndryshe, megjithatë për këtë rast, për rastin e z. Shala
4 synimi është i njëjtë. Nuk ka dyshim që z. Shala ka pasur
5 synimin për vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe
6 kjo në vetvete është dëshmi e faktit që ai synonte që vrasja
7 të ishte pjesë e NKP-së.

8 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë se u ula.

10 Gjykatësi Jorgensen, pyetja juaj ka të bëjë me
11 interpretimin nga Prokuroria të rregullës 144 dhe, domethënë,
12 pyetja që bëtë ju është që çfarë qëndrimi kemi ne për sa i
13 takon dëshmive ose provave të paverifikuara ose dëshmitë e
14 personave të cilët nuk kanë qenë në proces gjyqësor a janë të
15 mjaftueshme ato për të provuar apo për të verifikuar një
16 incident të vetëm që është pjesë e disa incidenteve të tjera
17 që mund të përbëjnë bazën për një vendim dënimi ose për
18 trajtimin, ndalimin arbitrar, torturën e tjerë, a e kam
19 kuptuar siç duhet?

20 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Po dhe çfarë pikëpamje
21 keni ju për sa i takon autoriteteve përkatëse.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sipas
23 qëndrimit tonë si jurisprudenca ndërkombëtare penale dhe ajo e
24 të drejtave njerëzore lejojnë mundësinë e vërtetimit të një
25 incidenti të vetëm kriminal mbi bazën e provave të

1 paverifikuara, megjithatë kjo nuk është baza e vetme dhe
2 vendimtare për sa i takon shpalljes së dënimit të fajësisë.

3 Megjithatë në çështjet Djordjevic, Popovic dhe Karadzic,
4 TPNJ ka thënë që parimi i një incidenti të vetëm mund të
5 vërtetohet mbi bazën e provave të paverifikuara në qoftë se
6 ato shoqërohen nga konfirmime të caktuara. Po ashtu kjo lidhet
7 me një analizë specifike të fakteve, pra, sa i takon
8 konfirmimit se çfarë mund të jetë, çfarë trajte mund të ketë
9 një konfirmim i tillë. Sipas këtyre aktgjykimeve kjo mund të
10 ketë forma të ndryshme. Për shembull, mund të jetë forma e
11 fakteve të gjykuara të cilat konfirmojnë dëshminë e një
12 dëshmitari të vetëm ose mund të jenë gjithashtu dëshmi që
13 demonstrojnë një model sjelljeje të ngjashëm me atë që është
14 dëshmuar ose është deklaruar nga dëshmitarët të cilët kanë
15 dalë dhe kanë dhënë dëshmi përpara Trupit Gjykues. Më
16 konkretisht, këtu i referohem aktgjykimeve që apelit Popovic,
17 paragrafi 104, aktgjykimit të apelit në çështjen Karadzic,
18 paragrafi 457 dhe 459 dhe aktgjykimi i apelit i Djordjevic, në
19 paragrafin 809.

20 Tani, për zbatimin e këtij parimi. Provat e dëshmitarëve
21 si [REDAKTUAR], dha dëshmi,
22 për shembull, se të gjithë të ndaluarit, të gjithë të
23 ndaluarit në Dhomën 1 janë rrahur. Kjo konfirmoi dëshminë e
24 dëshmitarëve të rregullës 153 dhe 155 që dhanë dëshmi të
25 ngjashme për të njëjtin vend në dhomën ngjitur me Dhomën 1 në

1 të njëjtën periudhë kohore. Në këto rrethana, duhet të
2 mbështetmi në provat me shkrim sepse, sipas nesh, kjo është
3 krejtësisht legjitime.

4 Dëshiroj të shtoj se ekziston mundësia për Mbrojtjen të
5 bëjë kundërpyetjet e veta dëshmitarëve, [REDAKTUAR],
6 [REDAKTUAR] që u ndalua në të njëjtën kohë, kanë qenë të
7 ndaluar në të njëjtën kohë si me dëshmitarët që dhanë dëshmitë
8 me shkrim të ndaluar nga të njëjtit kryes në të njëjtin vend
9 dhe kjo është diçka që Trupi Gjykses e merr parasysh kur
10 vlerëson nëse duhet të mbështetet apo jo në provat që janë
11 dhënë me shkrim apo në dëshmitë që janë dhënë me shkrim.

12 Sidoqoftë rregulla 155 ka një ndalim për provat e
13 paverifikuara për rastet e shpalljes së fajësisë dhe kjo është
14 në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Të
15 Drejtave të Njeriut në fakt që përkufizon se dëshmi "decizive"
16 që mund të jenë me rëndësi të jashtëzakonshme për përfundimin
17 e një gjykimi duhen marrë parasysh. Kjo është rasti Jaupi
18 kundër Shqipërisë që mund ta shikoni si konfirmim, ju lutem,
19 me numër reference po ua jap është 23369/16, në paragrafin 99.

20 Kjo është korniza ligjore që duhet të merrni parasysh ju
21 dhe ku është bazuar Trupi Gjykses për dëshmitarët e rregullës
22 153 dhe 155 dhe, sipas nesh, ka qenë krejtësisht legjitime dhe
23 është krejt normale konstatimi që është bërë në aktgjykim për
24 dëshmitë me shkrim që janë marrë për bazë nga Trupi Gjykses.

25 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Tani dua të ftoj Mbrojtësin e Viktimave për përgjigjen e
4 tij. Keni një orë për përgjigjen tuaj.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit.

6 Dua të filloj duke thënë se për viktimat në këtë lëndë
7 gjyqësore kjo seancë apeli është një gurë kilometrik shumë i
8 rëndësishëm në përpjekjet e tyre për të gjetur drejtësi.

9 Gjatë gjykimit dhe gjatë argumenteve përmbyllës, si dhe
10 në dosjen e apelit, Mbrojtja është përpjekur t'i kritikojë,
11 t'i qortojë viktimat që dhanë dëshmi duke i etiketuar ata si
12 të pambështetshëm dhe si persona që s'kanë thënë të vërtetën
13 dhe kjo u theksua edhe më shumë dje për të arritur të njëjtin
14 qëllim. Ne s'i pranojmë këto kritika njësoj sikurse nuk i
15 pranojë edhe Trupi Gjykses I.

16 Në emër të viktimave pjesëmarrëse, dua ta them qartë se
17 dëshmitë e tyre në fakt u konstatuan si të vërteta dhe u
18 pranuan, normal u pranuan nga Trupi Gjykses që e ka ndjekur
19 këtë gjykim.

20 Ne kemi trajtuar me hollësi me shkrim disa nga argumentet
21 e Mbrojtjes sepse kemi dashur të mbrojmë interesat e
22 drejtpërdrejta të viktimave dhe nuk dëshirojmë të përsërisim
23 të njëjtat parashtrime sot. Por disa shkurtimisht do të na
24 duhet t'i prekim.

25 Sigurisht që parashtrimi ynë kryesor është që nuk ka

1 asnjë bazë dhe nuk ka asnjë bazë të arsyeshme për të rrëzuar
2 aktgjykimin e Trupit Gjykses I. Përkundrazi Trupi Gjykses I në
3 këtë lëndë gjyqësore ka bërë një analizë të kujdesshme, një
4 analizë të drejtë edhe ka përcaktuar me hollësi bazën për
5 konstatimet e tyre.

6 Nuk do të shtjelloj asgjë lidhur me pikat 4 dhe 7 sepse
7 ju jemi përgjigjur me shkrim për këto. Por do të doja të flas
8 sot për pikën 6 të apelit dhe bashkëmbrojtësja, znj.

9 Radziejowska, do t'ju përgjigjet për pikën 14 edhe do t'ju
10 përgjigjet pyetjeve tuaja lidhur me relevancën e Gjykatës
11 Kushtetuese, vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

12 Ky është plani ynë për sot, po fillojmë menjëherë. Po
13 fillojmë menjëherë me shpërdorimin e diskrecionit që është
14 pika 6 e apelit të Mbrojtjes.

15 Mbrojtja duke u përpjekur të kundërshtojë përfundimet e
16 Trupit Gjykses është përpjekur të fokusohet në mospërputhje
17 apo vështirësi të pretenduara në provat ekzistuese. E thashë
18 dhe pak më herët, është bërë shumë përpjekje nga ana e
19 Mbrojtjes që të vërë në dyshim besueshmërinë dhe i kanë
20 akuzuar viktimat se janë gënjeshtarë dhe janë të pabesueshëm,
21 në mënyrë që të vihet në dyshim e vërteta.

22 Megjithatë përpjekjet e tyre ishin pa rezultat. Trupi
23 Gjykses i pranoi qartë se viktimat ishin dhe të besueshëm dhe
24 të mbështetshëm dhe kjo shërbeu për aspektet kryesore të kësaj
25 lënde gjyqësore.

1 Mbrojtja, tani, në këtë situatë e zgjeroi edhe më shumë
2 sulmin duke fajësuar Gjykatësit që pse pranuan si të vërteta
3 dëshmitë e viktimave. Sipas tyre ka probleme në këtë lëndë
4 gjyqësore, dhe probleme kaq të mëdha saqë asnjë Trup Gjykues
5 nuk duhet ta kishte shpallur fajtor personin edhe madje ky
6 Trup Gjykues ka qenë i anshëm. Sa i takon mungesës së
7 paanshmërisë mund të lexoni paragrafët 80, 93, 112, 196, 203
8 të dosjes së apelit të Mbrojtjes.

9 Fjalja që përsëritet shumë shpesh aty është që për arsye
10 të paditura Trupi Gjykues ka pasur një version të vetin të
11 parapëlqyer që ishte në favor të viktimave dhe të Prokurorisë.
12 Sidoqoftë për këtë s'kishte kurrfarë baze dhe më tej s'kishte
13 asnjë lloj prove konkrete për të mbështetur këtë pretendim.

14 Pra, argumenti mesa duket mbështetet në hiçgjë thjesht në
15 faktin që Gjykatësit kanë pranuar provat e viktimave dhe
16 rrëzuan Mbrojtjen e z. Shala. Por një argument i këtillë nuk
17 mund të jetë i suksesshëm. Sepse nuk përmbushë kriteret e
18 përcaktuara nga jurisprudenca relevante edhe veçanërisht kjo
19 jurisprudencë është përmbledhur në apelin e parë të Mustafës
20 nga ky Panel Apeli. Më falni se po citoj fjalët tua që ju
21 vetë i keni thënë:

22 "Trupi Gjykues ju rikujton se ekziston prezumimi i
23 paanshmërisë i cili supozohet se e zbatojnë Gjykatësit dhe
24 Trupi Gjykues edhe pala apeluese mund ta kundërshtojë këtë
25 prezumim bazuar në prova të përshtatshme dhe të besueshme."

1 Është paragrafi 40 i vendimit tuaj.

2 Pra, duhet të kenë prova të përshtatshme dhe të
3 besueshme. Megjithatë s'ka asnjë provë deri tani për të
4 kundërshtuar dhe për të mbështetur pretendimin e tyre se Trupi
5 Gjykues ka qenë i anshëm.

6 Tani dua të flas për provat dhe të trajtoj disa nga
7 kritikat konkrete që bëri Mbrojtja dje. Edhe për këtë unë dua
8 të kemi parasysh kriterin që përcaktohet në Nenin 46(5) të
9 Ligjit që unë nuk do ta citoj, po thjesht dua që ta keni
10 parasysh, po ashtu ju lutem të keni parasysh paragrafin 24 të
11 apelit të Mustafës.

12 Të bëjmë një analizë të besueshmërisë të Trupit Gjykues.
13 Po bazohem tek Pika 6(a) e dosjes së Mbrojtjes lidhur me
14 Dëshmitarin numër 01.

15 Në paragrafët 98 dhe 118 të aktgjykimit, Trupi Gjykues ka
16 bërë një vlerësim shumë të hollësishëm të besueshmërisë së
17 Dëshmitarit numër 01, është e rëndësishme të theksojmë se sa e
18 vështirë ishte të bëhej një vlerësim i tillë. Sepse duheshin
19 marrë materiale të ndryshme shkresore dhe të analizoheshin
20 këto materiale për të parë nëse Dëshmitari numër 01 ishte një
21 person i besueshëm. Paragrafi 101 u konstatua se natyra e
22 dëshmisë së tij ishte e vështirë dhe mënyra e tij, në fakt, ai
23 ishte koherent. Dëshmia e tij kishte "plot hollësi" edhe ata
24 ngelën të habitur nga sjellja e tij sepse ai ishte koherent
25 gjatë gjithë dëshmisë së tij.

Pra dhe përmbajtja por dhe paraqitja e tij në sallën e gjyqit i la të befasuar Gjykatësit. Këto janë përfundime të rëndësishme. Sepse këto janë baza për një vlerësim pozitiv të besueshmërisë së këtij personi.

Por ka dhe një shumëllojshmëri të tjera materialesh që pati Trupi Gjykues përpara dhe që mbështesnin dëshminë e dëshmitarit numër 01, nuk është rëndësia t'i lexoj të gjitha këto materiale. Por, shkurtimisht, dua të përmend disa nga materialet kryesore përpara se të flas për kritikën e Mbrojtjes. Paragrafi 102, ngjyrimi i dëshmisë së tij, kujdesi, sa i kujdesshëm ishte ai që të mos e implikonte z. Shala kur tha se nuk i kujtohej me hollësi incidenti dhe nëse ka qenë i pranishëm apo jo z. Shala. Paragrafi 103, mbështetja, në fakt, fakti që dëshmia e tij u mbështet edhe nga dëshmitarë të tjerë dhe kjo ishte e konsiderueshme dhe kështu me radhë.

Ju lutem të kalojmë në seancë private në mënyrë që të trajtojmë disa nga parashtrimet e djeshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

- 1
- [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

- 1
- [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

- 1
- [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Kalojmë tek Pika 6B që ka lidhje me

22 Dëshmitarin 04733. Është bërë një analizë e Trupit Gjykues në

23 paragrafët 179, 188, 695. Këto paragrafë janë të shtjelluara

24 shumë mirë. Pra, asgjë nga gjërat që ka thënë dhe ka bërë

25 Mbrojtja nuk e vë në dyshim analizën e Trupit Gjykues.

Argumenti i tyre është se kur dëshmitarët e Mbrojtjes rezultuan se kishin mospërputhje në dëshmitë e tyre, Trupi Gjykues i rrëzoi dhe në raste të tjera ata kanë pranuar dëshmitarët e Prokurorisë pavarësisht se edhe ata kishin mospërputhje në dëshmitë e tyre. Dhe sipas tyre ka qenë një standard i dyfishtë i zbatuar nga Trupi Gjykues.

Ne themi që ne, në fakt, e kemi shtjelluar me shkrim - mund të shikoni paragrafin 58 të dosjes tonë - është kjo jo të gjitha mospërputhjet kanë të njëjtën peshë. Dhe në parashtrimet ne kemi marrë parasysh rregullën 139(2) dhe rregullën 139(6), që trajtojnë specifik rastet e mospërputhjeve të dëshmimeve edhe qasja që duhet ndërmarrë në raste të tilla dhe çfarë ka bërë Trupi Gjykues në këtë rast.

Po vazhdoj më tej lidhur me Dëshmitarin 4733, kritikën e djeshme për këtë person.

Fillimisht identifikimi. Edhe fakti që ai ka thënë që z. Shala ishte zeshkan edhe si u mbështet Trupi Gjykues në një fakt të tillë, Mbrojtja thotë, kjo është krejt anormale. Kjo nuk është e vërtetë sepse pamjet e njerëzve nuk ndryshojnë me kalimin e kohës. Ndonjëherë, në fakt, pamjet e njerëzve ndryshojnë edhe brenda një viti në varësi të klimës.

Po kjo është shumë selektive. Mund të lexoni më tej paragrafin 451 lidhur me këtë, ka më shumë detaje sesa kaq në këtë paragraf. 0404733 e njohu z. Shala nga fotografitë që i kishte parë përpara luftës. Ai, z. Shala, i kanë thirrur me

1 emër anëtarët e tjerë të UÇK-së me nofkën Ujku, pra, Ujku, i
2 kanë thirrur të tjerët dhe madje ai edhe ulërinte si ujk në
3 praninë e Dëshmitarit 4733. Pra, z. Shala e ka pranuar vetë që
4 kjo ishte një nga format si ai i përshëndeste njerëzit.

5 Po ashtu, çështja e identifikimit të z. Shala nga
6 Dëshmitari 4733 nëse e identifikoi siç duhet. Në faqen 26 të
7 transkriptit të djeshëm thuhet që dhe Dëshmitari numër 09 i
8 Prokurorisë tha po ashtu që ky personi që mendohet se ishte
9 Pjetër shala kishte ardhur nga Kroacia. Kjo është një
10 shtrembërim faktesh.

11 Ju lutem shikoni transkriptin në faqen 1007, do të
12 shikoni po ta lexoni transkriptin se nuk është kaq e thjeshtë.
13 Dëshmitari numër 09 tha se:

14 "Një person ka thënë se ai" - Shala - "ka ardhur nga
15 Kroacia këtu ... Një person ma tha këtë."

16 Pra, dikush në fshatin e tij ia ka thënë këtë lidhur me
17 z. Shala dhe ku kishte qenë ai më përpara dhe dëshmitari e
18 ndau këtë informacion me Trupin Gjykues kur i bënë pyetje. Kjo
19 mbase s'mund të merret fare për bazë edhe kjo nuk duhet të
20 vërë në dyshim besueshmërinë e Dëshmitarit numër 09.

21 Në faqen 25 të transkriptit të djeshëm, Avokati Mbrojtës
22 tha [REDAKTUAR]
23 [REDAKTUAR]
24 [REDAKTUAR]
25 [REDAKTUAR].

1 Prapë nuk po jepet panorama e plotë. [REDAKTUAR]
2 [REDAKTUAR] por kjo ka ndodhur në
3 vendin ku e ndaluan fillimisht. Është në një fshat që quhet
4 Rromanat. Ju lutem shikoni paragrafin 48 të aktgjykimit lidhur
5 me këtë.

6 Pra, dëshmitari mund të thotë që Dëshmitari 06 ka menduar
7 se ishte Kukësi. Por për shkak se ka kaluar situata të
8 ndryshme të vështira, poshtërime, keqtrajttime vetë ai si
9 persona edhe familja e tij, mund të themi se kjo është një
10 mospërputhje e vogël. Fakti që anëtarë të familjes mund ta
11 kenë dëgjuar gabimisht ose mbase nuk i kujtohet saktë vendi ku
12 ka ndodhur keqtrajtimi, por nuk mund të thuash bazuar në këto
13 që Dëshmitari 4733 nuk është i besueshëm.

14 Dhe i njëjti vlerësim vlen dhe për kritikën e tjera të
15 provave nga familja.

16 Edhe këtu dua të theksoj një pikë nga përgjigja jonë në
17 paragrafin 64. Në gjykim, Mbrojtja theksoi sidomos
18 mospërputhjet në dëshminë e pjesëtarëve të familjes së
19 Dëshmitarit 4733. Shih aktgjykimin paragrafi 149, 150.

20 Po të shohim dosjen e apelit të Mbrojtjes në paragrafin
21 101, ata theksojnë ngjashmëritë në dëshmitë e tyre dhe kjo
22 thuhet për të sugjeruar që ata janë përfshirë në "një
23 përgatitje përsëritje të dëshmisë që do të jepnin pastaj". Dje
24 Mbrojtja përsëriti parashtrimet e tyre duke thënë që historitë
25 e tyre u kthyen, ndërruan, pra, duke thënë që tregimet e tyre

1 nuk përputhen.

2 Pra, në qoftë se tregimet e tyre përputhen, janë marrë
3 vesh paraprakisht. Në qoftë se ato nuk përputhen ato, ato janë
4 dëshmi që në të cilat nuk mund të mbështetesh. Me këtë lloj
5 qasjeje, asnjë grup dëshmitarësh nuk mund të pranohej, nuk do
6 të pranohej si i besueshëm. Dhe kjo tregon që ajo që
7 pretendohet këtu është një argument i përgjithshëm dhe i
8 padobishëm që bazohet në asgjë më shumë sesa përgjigje të
9 përgjithshme të Mbrojtjes ndaj provave fajësuese.

10 Pas dënimit të tij bazuar për dëshmi të besueshme dhe të
11 fuqishme, Mbrojtja kërkon të minojë, pra, këtë dënim,
12 shpalljen fajtor, duke paraqitur anshmërinë e Gjykatësve si
13 arsye e këtij rezultati. Ajo që ata mund të thonë është që
14 Gjykatësit kanë patur një preferencë të historisë apo tregimit
15 që është anshmëri për të arritur në konstatimet e tyre që janë
16 në kundërshtim me provat. Me fjalë të tjera dhe sipas analizës
17 së tyre, Shala fillimisht është akuzuar në mënyrë të padrejtë
18 dhe pastaj gjykuar në mënyrë të rrejshme, pra, të padrejtë. Ka
19 një shpjegim dhe më të thjeshtë sesa teoria e komplotit që
20 paraqitet nga Mbrojtja dhe kjo është që Trupi Gjykses thjesht
21 kishte të drejtë, ata e dinin të vërtetën dhe e njihnin atë
22 kur e dëgjonin dhe mund të identifikonin rastet e pavërteta
23 kur paraqiteshin në emër të z. Shala.

24 Realiteti, ne themi, është që Mbrojtja mbështet një
25 propozim tërësisht të paserioz dhe të pabazuar sepse nuk

1 zgjedh që të mos pranojë faktin e natyrshëm dhe të qartë.

2 Viktimat ishin aty, në të gjitha aspektet kyçe të kësaj
3 çështjeje dhe këto viktima kanë thënë thjesht të vërtetën.

4 Ka tregim të preferuar këtu, por është ai i Trupit
5 Gjykues I.

6 Dhe ftojme Panelin e Apelit që të rrëzojë pikat që ne
7 përmendëm dhe për të cilat sollëm argumente.

8 Dhe përveç, në qoftë se ju keni pyetje të tjerë, do të
9 propozoj tani që t'i jap fjalën bashkëmbrojtëses time, znj.
10 Radziejowska, për të trajtuar Pikën 12 dhe Gjykatën
11 Kushtetuese.

12 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në
13 parashtrimet e mia do të filloj duke u përgjigjur pyetjes suaj
14 lidhur me pikën 14 të apelit të Mbrojtjes dhe pastaj do t'i
15 përgjigjem disa çështjeve të ngritura nga Mbrojtja në
16 parashtrimet e tyre gojore që kanë të bëjnë me gabimet e
17 pretenduara në përcaktimin e dënimit.

18 Të nderuar Gjykatës ju pyetët për pikëpamjen tonë lidhur
19 me faktin nëse aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen
20 Mustafa i lëshuar më 17 prill 2025 ndikon në konstatimet e
21 Trupit Gjykues për përcaktimin e dënimit dhe sipas pikëpamjes
22 tonë përgjigja e kësaj pyetjeje është shumë e thjeshtë: Nuk
23 ndikon. Kjo sepse konstatimet e Trupit Gjykues për përcaktimin
24 e vendimit janë në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës
25 Kushtetuese.

1 Dhe ne pajtohemi tërësisht me parashtrimet e bëra lidhur
2 me këtë pikë nga Prokuroria më herët sot. Më lejoni që të
3 sqaroj, të shpjegoj qëndrimin tonë.

4 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen Mustafa ka
5 dy nivele pasojash apo implikimesh. E para ka të bëjë me
6 regjimin e përcaktimit të dënimit të zbatueshëm përpara
7 Dhomave të Specializuara të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e ka
8 bërë të qartë, e bëri të qartë se - do konstatoj vetëm
9 konstatimet kyçe, kryesore - se Dhomat e Specializuara
10 konfirmojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në
11 Kushtetutën e Kosovës, përfshirë dhe parimin e ligjit më të
12 butë. Megjithatë, ata e bëjnë këtë brenda kornizës ligjore
13 autonome të Dhomave të Specializuara, pra, të pavarura.

14 I vetmi ligj që duhet të zbatohet në përcaktimin e
15 dënimit nga Dhomat e Specializuara është ligji që është
16 detyrues për Dhomat e Specializuara. Dhe parimi i ligjit më të
17 butë është i zbatueshëm ndaj ligjeve që janë detyruese për
18 Dhomat e Specializuara.

19 Dhe paragrafi 42(2) (a) dhe (b) nuk mund të lexohet si
20 detyrues për Dhomat e Specializuara për të zbatuar shkallën e
21 dënimit të zbatuara në ligjet penale apo kodet e Kosovës
22 bashkëkohore apo ato pasuese. Për rrjedhojë ligji, parimi i
23 ligjit më të butë nuk zbatohet ndaj nenit 44(2) (a) dhe (b).

24 Kur shihet aktgjykimi në krahasim dhe duke pasur parasysh
25 konstatimet e Gjykatës Kushtetuese është e qartë që Trupi

Gjykues ka identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të duhur dhe të saktë ligjin e zbatueshëm dhe ka përcaktuar regjimin e përcaktimit të dënimit. Trupi Gjykues ka vlerësuar siç duhet se dënimi maksimal që mund të caktohej ishte burgim i përjetshëm dhe ka identifikuar në mënyrë saktë ligjet e zbatueshme në Kosovë në kohën e kryerjes së krimeve dhe ligjet relevante pasuese apo kodet e miratuara në Kosovë. Pastaj ka konstatuar se në mënyrë të duhur që kërkohet që këto dënime të cilat parashihen në ligjet e Kosovës të merren parasysh por nuk është i detyruar nga këto konsiderata apo vlerësime.

Shkalla, niveli i dytë i implikimeve apo pasojave të aktgjykimit të Gjykatës kushtetuese ka të bëjë me ndikimin në përcaktimin e dënimit në çështjen Mustafa të shtatorit 2024. Konkretisht, nëse ky një dënimi i ri, ripërcaktimi pra, mund të përdoret si referencë në këtë çështje në fakt apo në ndonjë çështje tjetër përpara Dhomave të Specializuara.

Vendimi për ripërcaktimin e dënimit në çështjen e z. Mustafa ishte i nevojshëm sepse Gjykata supreme, vendimi i Gjykatës Supreme në çështjen Mustafa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këtë vendim Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimi i apeluar i Mustafës i dhjetorit 2023 ishte në lidhje me dënimin në shkeljen e ligjit penal. Sipas Gjykatës Supreme, Paneli i Apelit nuk ka identifikuar shkallën e dënimit më të butë sipas ligjit të Kosovës që të merrej parasysh në përputhje me nenin

1 44(2) (b) të ligjit dhe parimin e ligjit më të butë.

2 Por Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj të prillit
3 të këtij viti e ka bërë të qartë që konstatimet e Gjykatës
4 Supreme ishin të gabuara.

5 Për rrjedhojë, udhëzimi i Gjykatës Supreme për Panelin e
6 Apelit që ju kërkonte juve të ripërcaktoni dënimin e z.
7 Mustafa dhe të udhëhiqeshit nga ai, ndër të tjera, që ishte
8 shkalla e përcaktimit të dënimit nga 5 në 25 vjet e
9 parashikuar dhe e paraparë nga Kodi Penal i Kosovës 2019 kjo
10 ishte e gabuar, pra, sipas Gjykatës Kushtetuese.

11 Shkalla në të cilën gabimi është pasqyruar, për të thënë,
12 në mënyrë matematikore, përllogaritja e dënimit të dytë është
13 e pamundur që të përcaktohet për ne. Është e paqartë pesha që
14 i është dhënë këtij vlerësimi. Megjithatë, është e vështirë të
15 shihet se si ripërcaktimi i dytë, pra, i dënimit të Mustafës,
16 ky vendim mund të shërbejë apo të përdoret si pikë e vlefshme
17 referimi. E kam marrë parasysh faktorin që nuk duhet të kishte
18 marrë fajtor.

19 Dënimi i përcaktuar ndaj z. Mustafa në këtë vendim, prej
20 15 vitesh burg, nuk mund të përdoret si mbështetje, si pika
21 reference në Dhomat e Specializuara. Përndryshe, interpretimi
22 i gabuar i Gjykatës Supreme, interpretimi i ligjit i gabuar
23 mund të vazhdojë edhe më tej dhe të përsëritet.

24 Dhe, përfundimisht, të nderuar Gjykatës, gjykata,
25 konstatimet e Gjykatës Kushtetuese e bëjnë të qartë që

1 aktgjykimi i apelit i dhjetorit 2023 ka interpretuar në mënyrë
2 të duhur dhe të saktë dhe zbatuar ligjin e zbatueshëm lidhur
3 me përcaktimin e dënimit dhe Trupi Gjykses në çështjen Shala
4 ka me të drejtë ka ndjekur aktgjykimin e apelit të çështjes
5 Mustafa në vitin 2023.

6 Tani, do t'i përgjigjem parashtrimeve gojore të Mbrojtjes
7 nga dje, të paraqitura dje.

8 Së pari, do të trajtoj parashtrimin e Mbrojtjes që ka të
9 bëjë me Nenin 7 të Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e
10 Njeriut.

11 Mbrojtja argumenton se së pari Trupi Gjykses nuk zbatoi
12 siç do të kishte bërë shkallën e dënimit bashkëkohor dhe që
13 kjo përbënte shkelje apo cenim të së drejtës të z. Shala sipas
14 Nenit 7 të Konventës. Kjo gjendet në faqen 46, rreshti 22 deri
15 në faqen 47, rreshti 1, i transkriptit të djeshëm.

16 Mbrojtja më tej zhvillon argumentin e saj lidhur me Nenin
17 7 dhe sugjeron se:

18 "Po të marrim parasysh shkallën e dënimit të vitit 1999
19 që kjo shkallë nuk është detyruese, atëherë ... bëhet gabim
20 dhe më themelor kur vlerësohet se nuk ka patur ligj që
21 parashihte një dënim për krimet për të cilat z. Shala është
22 dënuar në kohën e kryerjes së tyre."

23 Dhe kjo gjendet në faqen 47, rreshti 9, 12 i transkriptit
24 të djeshëm.

25 Dhe që të shtoj diçka përgjigjes së Prokurorisë lidhur me

1 këtë pikë. Të nderuar Gjykatës, parashtrimi i Mbrojtjes nuk
2 merr parasysh faktin se paragrafi 2 i Nenit 7 të Konventës
3 Evropiane parasheh si në vijim:

4 "Ky artikull nuk ndikon në gjykimin dhe dënimin e ndonjë
5 personi apo akti apo veprimi apo mosveprimi i cili në kohën
6 kur është kryer ka qenë kriminal, veprim apo kriminal sipas
7 parimeve të përgjithshme të ligjit të pranuar nga vendet e
8 qytetëruara."

9 Ne nuk mund të mohojmë ekzistencën e kësaj dispozite.

10 Dhe nuk mund të mohojmë që z. Shala është dënuar, është
11 shpallur fajtor dhe dënuar mbi bazën e Kodit Penal të ish-
12 Jugosllavisë të vitit 1976. Z. Shala është dënuar mbi bazën e
13 Nenit 14(1)(c) e Ligjit e cila përcakton krimet e luftës sipas
14 ligjit ndërkombëtar zakonor dhe është dënuar sipas Nenit
15 44(1), (2) dhe (5) të Ligjit.

16 E rëndësishme është të theksohet neni 44(2)(c) i Ligjit,
17 i referohet në mënyrë konkrete paragrafit të dytë të Nenit 7
18 të Konventës. Aty thuhet se Dhomat e Specializuara duhet të
19 marrin parasysh shkallën e dënimit për çdo veprim apo
20 mosveprim që ka qenë kriminale sipas parimeve të përgjithshme
21 të ligjit të pranuar nga vendet e qytetëruara, kjo do të
22 cenohej nga marrja parasysh e shkallës së dënimit, shkalla e
23 dënimit në fuqi në kohën bashkëkohore apo vijuese.

24 Të nderuar Gjykatës, Mbrojtja është e gabuar kur sugjeron
25 se përveç nëse zbatohet Kodi Penal i ish-Jugosllavisë i vitit

1 1976, të drejtat e z. Shala sipas nenit 7 të Konventës janë
2 shkelur në qoftë se ai nuk zbatohet.

3 Çështja e dytë e ngritur nga Mbrojtja dje dhe do ta
4 trajtoj shqetësimet e Trupit, dështimit të pretenduar të
5 Trupit Gjykues për të siguruar proporcionalitet në përcaktimin e
6 dënimit.

7 Mbrojtja pretendon që ky dështim është, shfaqet nga
8 dënimi i disproporcionuar që është caktuar ndaj z. Shala dhe
9 ata të caktuar ndaj z. Xhemshit Krasniqi, Sabit Geci dhe Salih
10 Mustafa.

11 Sa i takon dënimit të caktuar ndaj z. Mustafa, ne
12 vlerësojmë se vendimi i dytë për dënimin nuk duhet të jetë
13 pikë reference për Trupin Gjykues për arsyet që dhashë më
14 herët.

15 Sa i takon çështjes së diproporcionit të pretenduar për
16 sa i takon dënimit të caktuar ndaj z. Shala dhe atyre të
17 vendosur ndaj z. Xhemshit Krasniqi, Sabit Geci, ne
18 parashtrojmë se krahasimi i bërë nga Mbrojtja është me defekt
19 dhe i gabuar dhe ka çuar Mbrojtjen në përfundime të gabuara.

20 Për të bërë një krahasim të duhur të dënimeve duhet që të
21 shihet krimet specifike për të cilat Xhemshit Krasniqi, Sabit
22 Geci janë shpallur fajtorë dhe dënimet individuale të caktuara
23 ndaj secilit për secilin prej këtyre krimeve. Dhe për një
24 shpjegim më të hollësishëm dhe analizë më të hollësishme të
25 këtyre shpalljeve fajtor apo dënimeve ju referoj, të nderuar

1 Gjykatës, te përgjigja jonë ndaj dosjes së apelit të

2 Mbrojtjes, paragrafi 114, 119.

3 Për t'ju dhënë një shembull. Mbrojtja nuk e përmend dhe
4 shmang, nuk përmend faktin se as Xhemshit Krasniqi dhe as
5 Sabit Geci nuk janë dënuar shpallur fajtorë apo dënuar për
6 vrasje. Edhe pse çështja e tyre kishte të bënte me fakte të
7 ngjashme, ata nuk janë shpallur fajtorë për të njëjtat
8 veprime.

9 Një analizë e duhur e dënimeve individuale të caktuara
10 ndaj Sabit Gecit dhe Xhemshit Krasniqit për secilin prej
11 pikave të akuzave për të cilat janë shpallur fajtorë e bën të
12 qartë dhe të pamundur që të arrihet në përfundimin që dënimi i
13 z. Shala është në mënyrë të paarsyeshme i disproporcionuar,
14 kapriçoz dhe i tepërt.

15 Të nderuar Gjykatës, me këtë, për të përfunduar, ne
16 qëndrojmë pranë parashtrimeve të tona të bëra në përgjigjen e
17 Mbrojtësit të Viktimave dhe ju kërkojmë që të konfirmoni
18 shpalljen fajtor dhe dënimin e caktuar ndaj z. Shala nga Trupi
19 Gjykses.

20 Faleminderit.

21 GJYKATËSJA

22 PIKARD: [Përkthim] Faleminderit.

23 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kam vetëm një pyetje për ju,
24 znj. Radziejowska. Shpresoj që ta kem shqiptuar emrin siç
25 duhet. Ju thatë që ky Panel i Apelit dhe po citoj, "ka marrë

1 parasysh një faktor që nuk do të duhet të kishte marrë para",
2 në vendimin e dytë të dënimit të z. Mustafa.

3 A mund të na thoni cilin faktor Apeli i Panelit nuk duhet
4 të kishte marrë parasysh?

5 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Shkalla e dënimit, pra, më
6 e buta e parashikuar në udhëzimet e Gjykatës Supreme. Pra,
7 mendoj që ka qenë pika e dytë e udhëzimit.

8 Pra, nuk ishte e nevojshme për Panelin që të
9 identifikonte shkallën e dënimit më të butë dhe që ta merrte
10 parasysh, nuk kishte nevojë.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Tani do
13 bëjmë një pushim 20 minutësh. Dhe kthehemi në 12.10.

14 --- Seanca ndërpritet në orën 11.48

15 --- Seanca rifillon në orë 12.13

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirë se
17 erdhët. Paneli i Apelit tani do të dëgjoj kundërpërgjigjen e
18 Mbrojtjes së z. Shala.

19 Keni 40 minuta, z. Avokat, deri në orën 12.50.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar
21 Gjykatës. Do të filloj, z. Aouini do të vazhdojë, pastaj znj.
22 Cariolou do të përfundojë ndërhyrjen tonë.

23 Pra, do të doja të theksoj diçka lidhur me dje. Duket që
24 dje disa persona kuptuan disa prej fjalëve të mia të
25 shqiptuara nga unë, në transkriptin e djeshëm në faqen 55,

1 rreshti 14 dhe 18, në transkriptin zyrtar të sotëm faqja 75,
2 rreshti 14 deri në 18, kur po flisja për përcaktimin e dënimit
3 këto fjalë u keqinterpretuan apo gabimisht në shqip apo u
4 keqkuptuan, me sa jam në dijeni, nga persona që dëgjojnë në
5 shqip.

6 Pra, më lejoni të jem shumë i qartë: Unë nuk kam thënë
7 asnjëherë që z. Shala kur iku në Belgjikë u shkëput nga grupet
8 kriminale apo nga ndonjë aktivitet kriminal. Kjo me sa duket
9 ka çuar disa persona të mendojnë që unë thashë që UÇK-ja ishte
10 një grup kriminal. Kjo nuk është e vërtetë natyrisht dhe kurrë
11 në jetë s'e kam menduar, as nuk e kam thënë. Të jetë e qartë
12 që UÇK-ja ka qenë në mbrojtje të popullit, grup për luftë
13 çlirimtare që ka bërë të mundur ekzistencën e shtetit të
14 Kosovës sot. Ky grup nuk ka qenë asnjëherë, kurrë, kriminal,
15 nuk ndiqet penalisht dhe, dua të them, se ka mbrojtur
16 popullin, popullatën ndaj një agresioni shtetëror. Kjo është
17 arsyeja për të cilën z. Shala është krenar që ka qenë pjesë e
18 UÇK-së.

19 Dhe kjo është ajo që thashë dhe kjo është ajo që po
20 përsëris. Z. Shala ka shkuar në Belgjikë për të jetuar një
21 jetë me dinjitet, respekt të ligjit, i lirë nga çdo lloj
22 kriminaliteti apo ilegaliteti në Belgjikë. Është e qartë dhe
23 kjo është e gjitha. Tani mund të kaloj tek pika e dytë dhe e
24 fundit.

25 Të nderuar Gjykatës, ju lutem shqyrtoni atë që është bërë

1 në aktgjykim dhe mbi apelin lidhur me NKP-në. NKP-ja ka të
2 bëjë, është pra, një mënyrë pjesëmarrjeje në një krim, siç e
3 dini ju shumë mirë, por nuk mund të jetë në asnjë mënyrë një
4 mënyrë për të atribuuar apo marrë përsipër përgjegjësi penale.
5 Përgjegjësia penale duhet të jetë personale, individuale,
6 natyrisht, bazuar në faktet apo veprimet e kryera nga personi
7 që vepron sipas një gjendjeje mendore të caktuar. Natyrisht,
8 nuk bëhet fjalë që të ngatërrohen këto dy elemente me situatën
9 e një individi tjetër për të siguruar përgjegjësi penale
10 përmes ngatërimit apo duke zëvendësuar njërin me tjetrin.

11 Pra, cili është fakti i vërtetuar? Bëj pyetjen: Cili
12 është fakti i vërtetuar i kryer për veprim apo fakti i kryer
13 nga z. Shala? Që do të ishte një lloj, një lidhje e sigurtë që
14 krijon një lidhje të drejtë të sigurtë me vdekjen siç ka
15 ndodhur në këtë rast. Në NKP I, nuk bëhet fjalë për pranimin e
16 shkaktimit të vdekjes apo rrezikun e vdekjes ndërkohë që nuk
17 është vërtetuar asgjë sa i takon planit të përbashkët për ta
18 përdorur këtë që dhe që z. Shala paska qenë pjesë e tij.

19 Nëse ju konfirmoni aktgjykimin dhe interpretimin sa i
20 takon NKP-së I, do të konfirmoni dhe të shkaktoni një zhvillim
21 katastrofik real sepse kjo do të krijonte mundësinë e *mens rea*
22 që dhe mundësisë për krimin e vrasjes që të ekzistojë brenda
23 NKP-së përfshirë krimin e vrasjes si qëllim i kësaj.

24 Pra, çfarë do të ndodhë më tej? Shpallje fajtor për krim
25 pa *actus reus* dhe pa *mens rea*? Dhe tani parimi i ligjshmërisë

1 dhe dua t'ju them qartë. Në qoftë se e ndiqni atë që propozon
2 ekipi i Prokurorisë dhe aktgjykimi, cili është
3 parashikueshmëria e krimeve apo njerëzit në vitin 1999?

4 Pra, ne do të kërkojmë, me respekt, që ta shfuqizoni
5 dënimin dhe të lironi atë për të gjitha pikat e akuzës.
6 Faleminderit shumë.

7 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

8 Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Shkurtimisht do të
9 merrem me kundërpërgjigje ndaj përgjigjes nga kolegët e mi të
10 ZPS-së në faqen 81, 88 lidhur me pyetjen, si përgjigje ndaj
11 pyetjes tuaj të dytë, të nderuar Gjykatës, që ka të bëjë me
12 Pikën 7, ju kërkuat referencat për dëshminë gojore sa i takon
13 ndalimit të katër individëve të caktuar.

14 Do të qëndroj në seancë publike, do të përpiqem që të
15 sigurohem që të mos zbuloj informacione identifikuese dhe do
16 të ndjek të njëjtin rend të individëve në fjalë siç janë
17 përdorur nga Prokuroria me qëllim që të mbesim në seancë
18 publike.

19 Sa i takon individit të parë të cilit ZPS-ja i referohet,
20 kolegët tanë, kolegë nga Prokuroria i referohen si Dëshmitari
21 01. Në fakt, ky dëshmitar i Prokurorisë përmend vetëm emrin e
22 një personi dhe vetëm emrin e djalit. Dhe kjo gjendet në faqet
23 e transkriptit 1433, 1434. Pjesa e copëzave të provave të
24 tjera që Prokuroria është përpjekur të mbledhë vijnë nga
25 dëshmi të patestuara, të paverifikuara. Ne nuk kemi mbiemrin,

1 nuk kemi informacion, identifikim konkret të personit, të
2 djalit, të djemve, origjina apo ndonjë identifikim të afërm të
3 individit konkret.

4 Kjo është e qartë dhe për individin e dytë që të cilit do
5 t'i referohem si e ndaluara femër. Dëshmia gojore e
6 Prokurorisë është dhe këtu kemi Dëshmitarin e Prokurorisë 01,
7 është referencë abstrakte dhe këtu po citoj, "dy motra nga
8 Gjykova", pa patur asnjë emër. Dhe kjo gjendet në faqet 1563
9 deri në 1567 të transkriptit të djeshëm.

10 Emri i të ndaluarës femër të parë përmendet në dëshminë e
11 patestuar, të paverifikuar. Vetëm emri. Vetëm emri. As nuk ka
12 mbiemër. Nuk përmendet motra. Nuk përmendet fshati nga ku
13 vjen. Nuk kemi fotografi identifikimi. Asgjë. Vetëm supozime
14 algoritme dhe sugjerime që janë përpjekje të Prokurorisë dhe
15 që nuk kanë vend në një procedurë penale.

16 Nuk bëhet situata më e mirë, është e njëjta gjë dhe me
17 individin e tretë, të nderuar Gjykatës, Dëshmitari 04. Edhe
18 këtu nuk kemi dëshmi gojore, pra, të dhënë në sallë të gjyqit
19 dhe Prokurori i referohet të njëjtit dëshmitar, Dëshmitarit
20 01. Në fakt, të nderuar Gjykatës, [REDAKTUAR]
21 [REDAKTUAR]
22 [REDAKTUAR] dhe ai
23 thjesht e mohoi këtë gjë. Kjo gjendet në faqen e transkriptit
24 1908.

25 Dhe më e fuqishme është që për të përfunduar me individin

1 e katërt. Prokuroria u përpoq të cilësonte Dëshmitarin e
2 Prokurorisë 11, në dëshminë e tij të dhënë me gojë, që ai
3 ishte mbajtur i ndaluar së bashku [REDAKTUAR] si provë për
4 mbështetje të pretendimit për këtë individ. Dhe edhe këtu
5 gjatë kësaj dëshmie të Dëshmitarit 11, ky dëshmitar
6 identifikoi një tjetër person, Dëshmitarin 4733, [REDAKTUAR]
7 që i ishte treguar në fotografi. Kjo gjendet në faqen e
8 transkriptit 1307, 1309 dhe në faqen 1328.

9 Kjo e bën të qartë edhe e thekson më shumë, të nderuar
10 Gjykatës, nivelin e përafërsisë dhe hamendësimet në gjendjen
11 hamendësuese në të cilën gjendemi si dhe rrezikun e provave të
12 patestuara, të paverifikuara dhe pa ballafaqim të
13 drejtpërdrejtë në Gjykatë. Trupi Gjykues vetë deklaroi në
14 paragrafin 426 se dhe po citoj:

15 "Fakti që [Dëshmitari i Prokurorisë 11] gabimisht besoj
16 që [Dëshmitari 4733] ishte [REDAKTUAR] bazohet në atë që ai
17 kishte dëgjuar nga të tjerët apo që i është -- dhe gjithashtu
18 shpjegohet nga fakti që disa prej të ndaluarve të mbajtur në
19 FMK [REDAKTUAR] dhe se
20 ai për rrjedhojë i ka ngatërruar."

21 Pra, Prokuroria u përpoq shumë dje që të mbushte këto
22 boshllëqet dhe që të lidhte gjërat së bashku, por pa i patur
23 ata që të japin dëshmi. Të nderuar Gjykatës, fakti është,
24 qëndron se këto pretendime dhe shpallja fajtor e z. Shala dhe
25 për krimet e pretenduara e shkaktuara mbi këta katër individë

1 mbështetet vetëm dhe ekzkluzivisht në dëshmi të patestuara, të
2 paverifikuara që është e papërcaktuar dhe në vetvete e
3 pamjaftueshme.

4 Tani për t'ju përgjigjur shkurtimisht asaj që u tha sot
5 në disa pika do të kërkoja që të kalojmë në seancë private.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mund të
7 kalojmë në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

8 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit. Po ia kaloj fjalën

9 znj. Cariolou për të përfunduar parashtrimet tona.

10 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

11 E kam parasysh kohën që kam në dispozicion, kështu që do të

12 përpiqem që t'i përgjigjem sa më shumë pikave të bëra dhe

13 sigurisht që dua që t'i përgjigjem edhe pyetjeve që u bënë.

14 Së pari, dëshiroj që ta ritheksoj edhe një herë qëndrimin

15 tonë që nuk është e mjaftueshme në ligj që të argumentohet që

16 anëtarët e NKP-së së pretenduar në Kukës kanë synuar që të

17 vrasin të ndaluar në përgjithësi dhe viktimën e vrasjes së

18 paligjshme që ka qenë një i ndaluar dhe si rezultat që z.

19 Shala që pretendohet që të ketë qenë një anëtar i NKP-së, të

20 pretendohet gjithashtu që ka pasur synimin për të vrarë

21 viktimën e vrasjes së paligjshme.

22 Dhe qëndrimi ynë është që ky qëllim nuk ka ekzistuar.

23 Së dyti, ne kërkojmë që të trajtohet kërkesa *mens rea* për

24 krimin e luftës së vrasjes së paligjshme. Ne përmendëm dje

25 jurisprudencën e konsoliduar që është në përputhje me

1 aktgjykimin e Trupit Gjykses për çështjen Mustafa dhe që është
2 pranuar si e pranueshme sa i takon synimit të tërthortë dhe si
3 e mjaftueshme sa i takon *mens rea* për vrasje.

4 Po ashtu, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, më lejoni
5 të shtoj diçka tjetër: Mbrojtja nuk pajtohet me synimin e
6 vagullt si të mjaftueshëm për krimin e luftës së vrasjes.
7 Pranimi i një synimi të tillë të vagullt si i mjaftueshëm
8 është një mjet juridik dhe, në fakt, e njëjta gjë vlen edhe
9 për formën e përgjegjësisë penale në NKP. Ndërkohë që
10 kombinimi i të dyjave në këtë çështje gjyqësore i bën të
11 mundur Prokurorisë që të bëjë një akrobaci të tillë mendore
12 dhe kjo nuk është e drejtë dhe nuk duhet të pranohet, ky është
13 parashtrimi ynë.

14 Jo vetëm kaq, por çështja e Prokurorisë dhe provat,
15 qëndrimi i Prokurorisë që u theksuan dje dhe sot, sipas të
16 cilit Shala kishte synimin e drejtpërdrejtë për të vrarë nuk
17 qëndron. Po ashtu sa i takon formës së përgjegjësisë penale
18 për dënimin për vrasjen, domethënë, përkatësisht për formën e
19 parë për NKP-në kërkon shfaqen e synimit të drejtpërdrejtë.

20 Sikurse u tha, qëndrimi për sa i takon pyetjeve të
21 apelit, në qoftë se konstatimi për sa i takon synimit të
22 Shalës për të vrarë viktimën e ndalimit, sipas nesh, pra,
23 është diçka që nuk përkon me qëndrimin e Prokurorisë. Ne
24 mendojmë që kjo në vetvete është mjaftueshëm për të tjetërsuar
25 konstatimin e diskutueshëm të Trupit Gjykses që Shala ka

1 synuar që të vrasë viktimën e vdekjes së paligjshme më 4
2 qershor.

3 Po ashtu, Trupi Gjykses ka konstatuar që z. Shala ka
4 pasur synim për të vrarë më datën 20 maj ose rreth asaj date
5 për shkak të nivelit të dhunës që është ushtruar mbi të
6 ndaluarit. Megjithatë nuk ka pasur vrasje të paligjshme në atë
7 datë. Është po ashtu e nevojshme që të ketë një koincidencë të
8 aktit të *mens rea* dhe të *actus reus* dhe Prokuroria duhet të
9 tregojë që *actus reus* dhe *mens rea* kanë ndodhur në të njëjtën
10 datë.

11 Por Trupi Gjykses, po ashtu, ka konstatuar se z. Shala
12 ka pasur synimin për të vrarë për shkak të deklaratës që janë
13 lidhur me to ose që ka bërë ai sipas të cilit z. Shala i ka
14 thënë një tjetër të ndaluar, jo viktimës që ka vdekur por në
15 një datë tjetër të ndryshme nga data për të cilën bëhet fjalë,
16 pra, kur ka vdekur viktimë në fjalë që ai do ta vriste atë.
17 Megjithatë, ky i ndaluar, që është Dëshmitari 4733, nuk ka
18 vdekur në Kukës.

19 Së fundi, Trupi Gjykses ka arritur në përfundimin se z.
20 Shala ka pasur synimin të vrasë për shkak të pjesëmarrjes së
21 tij në keqtrajtimin e viktimës në fjalë pasi ai e ka parë me
22 sytë e vet që viktimë të jetë qëlluar me armë.

23 Së pari, ne përsërisim qëndrimin e Mbrojtjes, që Mbrojtja
24 nuk e pranon që z. Shala ka qenë i pranishëm kur është
25 keqtrajtuar apo kur është qëlluar me armë viktimë. E vetmja

1 dëshmi që e vendosë atë atje është e debatueshme, është provë
2 e debatueshme dhe është dhënë nga një dëshmitar i cili për
3 arsye të shumta, të cilat ne i kemi parashtruar në dosjen
4 tonë, nuk duhet të konsiderohen si të besueshme.

5 Elementi i gabimit duhet që të jetë i pranishëm për sa i
6 takon elementit të *actus reus*. Prova nuk mbështet konstatimin
7 e sigurisë virtuale që Shala ka provuar veprimet të cilat
8 kërkohen që të përmbajnë elementin e gabimit.

9 Dhe dëshmitë të cilat janë administruar në këtë proces
10 gjyqësor dhe që i kemi parasysh nuk janë të mjaftueshme në
11 mënyrë të tillë që të vërtetohet siguria që kërkon gjendjen e
12 fajshme të të akuzuarit.

13 Neve arrijmë në përfundimin që nuk mund të arrihet në një
14 vendim fajësie vetëm mbështetur në provat e paverifikuara.

15 Po ashtu Trupi Gjykses kërkoi që të jepnim një përgjigje
16 lidhur me mbështetjen e palëve në aktgjykimin kundër Popovic
17 dhe Karadzic. Me gjithë respektin, do të doja të thoja që
18 Prokuroria në fakt po i shtrembëron jurisprudencën.

19 Ndërkohë në vendimet e apelit të Djordjevic, Popovic dhe
20 Karadzic nuk thuhet që mbështetja në një vendim dënimi në
21 provat e paverifikuara është në rregull ose është e pranueshme
22 për aq kohë sa në të citohet që do të ketë "disa" konfirmime
23 ose "ca konfirmime". Jo. Këto autoritete thjesht nuk kërkojnë
24 konfirmim por gjykimet janë konsistente dhe deklarojnë që
25 konfirmimi është i domosdoshëm.

1 Konfirmimi i konstatuar është i mjaftueshëm në ato raste
2 dhe është parë si provë solide ose bindëse sa i takon modelit
3 të sjelljes.

4 Tani dua të sjell në vëmendje të Panelit paragrafët 457
5 dhe 458 të dhomave të apelit në çështjen Karadzic.

6 Siç thuhet në paragrafët përkatës dhe në poshtëshënime në
7 këta paragrafë që nuk ka papajtueshmëri në jurisprudencë.
8 Popovic është në pajtim me çështjen Djordjevic dhe është
9 gjithashtu në pajtim ose konsistente edhe parimet e IHL-së mbi
10 këtë pikë: Nuk mund të ketë vendim dënimi të mbështetur vetëm
11 tek vendimi që ka si bazë të vet prova të pavërtetuara.

12 Prokuroria ndërkohë mbështetet në paragrafin 103 të
13 aktgjyimit të apelit të Popovic.

14 Ndërkohë do doja të thoja që në paragrafin 103 të
15 Karadzic dhe gjithashtu dhe në aktgjykimin e apelit të
16 Popovic, konfirmohet ky rregull. Dhe këtu dua që të citojmë
17 duhet që të shqyrtohen në qoftë se mbështetja kryesore është
18 tek dëshmia e paverifikuar e dëshmitarëve për të cilët po
19 flasim.

20 Kështu që dhe një herë do të doja që t'i kërkoja
21 Prokurorisë që t'i referohet vendimit të dhomës së madhe në
22 çështjen Al-Khawaja.

23 Pra, në çështjen Al-Khawaja nuk mbështetet qëndrimi i
24 Prokurorisë. Paneli mund ta konfirmojë këtë kur të lexojë
25 mbështetjen që i është bërë nga dhoma e madhe garancive që

1 ekzistojnë në të drejtën e Mbretërisë së Bashkuar sa i takon
2 mbështetëshmërisë tek provat e pavërtetësuara ose të
3 paverifikuara. I referohem gjithashtu paragrafit 156 të dhomës
4 së madhe të këtij vendimi dhe nga ana tjetër do të dua që të
5 sjell në vëmendjen tuaj dhe garancitë që ekzistojnë, pra,
6 është e nevojshme që, së pari, në rastin e dhomës së madhe që
7 të vërtetohej që provat të ishin regjistruar në formën e
8 duhur, së dyti, që të mbështeteshin nga prova të ankesës së
9 asaj kohe dhe që të mund të jepej gjithashtu edhe mundësia që
10 të bëhen kundërpyetje dhe elementi i tretë ishte që të
11 ekzistonte një ankesë e veçantë nga një paciente tjetër femër
12 e Dr. Al-Khawaja që ishte sulmuar nga Dr. Al-Khawaja në një
13 konsultim privat me të. Dhe po ashtu aftësia dhe
14 mbështetëshmëria e saj u verifikua gjerësisht gjatë
15 kundërpyetjeve të palës tjetër, ndërkohë që kjo nuk ka ndodhur
16 fare në çështjen kundër z. Shala.

17 Po ashtu, së fundi, është e rëndësishme që të vërehet që
18 çështja Al-Khawaja është një aktgjykim shumë i veçantë. Dhe
19 duhet të vlerësohet në kontekstin e vet. Pra, ka ndjekur
20 gjithashtu edhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Mbretërisë
21 së Bashkuar në një çështje tjetër.

22 Edhe një herë, Al-Khawaja ka ndjekur gjykimin,
23 aktgjykimin e Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar në
24 një çështje tjetër që quhet Horncastle dhe që është mbështetur
25 në jurisprudencën e Strasburgut.

1 Dua të shtoj gjithashtu që: Aktgjykimi i apelit të
2 Karadzic është lëshuar pasi është lëshuar aktgjykimi i apelit
3 për Al-Khawaja. Dy opinionet janë të lidhura me aktgjykimin e
4 apelit dhe tregojnë që ka pasur një diskutim të gjerë e të
5 gjatë lidhur me këtë pikë.

6 Është e rëndësishme të vërehet që dhoma e apelit në
7 çështjen Karadzic pas Al-Khawaja ka zbatuar në mënyrë të
8 padiskutueshme rregullin që ndalon dënimet mbështetur vetëm
9 dhe në mënyrë vendimtare tek provat e paverifikuara. Ky është
10 parashtrimi ynë, të nderuar Gjykatës.

11 Tani dua që të them dy fjalë lidhur me pyetjen që ka të
12 bëjë me provat shtesë që kanë të bëjnë me shqetësimet e
13 sigurisë. Shkurtimisht, përveç asaj që thamë dje dhe sot, ne
14 dëshirojmë që të themi këtë që: Spiunët nuk është e nevojshme
15 që të jenë luftëtarë. Spiunët nuk tentojnë që të jenë dukshëm
16 ose haptazi anëtarë të anës tjetër. Nuk është e thënë që
17 spiunët të jenë afër frontit. Spiunët nuk i shmangin kampet e
18 refugjatëve, po shpeshherë mund të jenë pjesë e tyre dhe
19 qëllimisht e bëjnë këtë gjë.

20 Parashtrimi ynë është që në këtë aspekt kjo nuk përkon me
21 realitetet e konfliktit të armatosur. Në parashtrimin tonë, ne
22 themi që dëshmi që vijnë nga të ndaluarit që janë pyetur në
23 mënyrë, pra, duhet që të trajtohen me kujdes, pra, çfarë ata
24 kanë thënë do të duhen të vlerësohen me kujdes.

25 Sikurse e thashë dhe pak më herët, në procedura penale

1 ndërkombëtare zor se ekzistojnë rregulla që ndalojnë pranimin
2 e provave. Fakti që dëshmia e dëshmitarëve është e pranueshme
3 si prova gjyqësore dhe që nuk mund të merret në konsideratë
4 mbi të cilën mbështetet Prokuroria është befasuese.
5 Megjithatë, është e drejtë të thuhet që dëshmi të tilla do të
6 duhet të merren me kujdes parasysht.

7 E njëjta vlen edhe për dëshmitë e anëtarëve të familjes.
8 Ne po flasim për pretendime që disa individë ishin spiunë.
9 Përgjigjet e Prokurorisë, se dyshime të tilla ishin të
10 paarsyeshme ndërmjet arsyeve të tjera për shkak të arsyes se
11 anëtarët e familjes së individëve të tillë kanë mohuar që
12 individë të tillë të kenë qenë spiunë. Megjithatë, me gjithë
13 respektin, të nderuar Gjykatës, anëtarët e familjes si mendoni
14 ju a do e kishin pranuar ndonjëherë që të dashurit e tyre
15 ishin spiunë?

16 Tani le të kalojmë tek dëshmitë e pavarura të cilat nuk
17 vijnë nga të ndaluarit. Përveç parashtimeve që kemi bërë ne
18 lidhur me këtë pikë, të cilat ua bëmë me dije dje, dëshirojmë
19 që të themi diçka lidhur me Dëshmitarin 10 që ka deklaruar në
20 dëshmi përpara Trupit Gjyqësor se që komandantët në Kukës dhe
21 këtu citoj, "kanë hetuar raste atje". Dhe citoj përsëri që
22 "ata kanë bërë punë hetuese ose hetimore në qoftë se dikush
23 ishte dyshuar që ishte dërguar nga Serbia për të mbledhur
24 informacion". Anëtarë të Panelit dua t'ju them që këtë e kam
25 marrë nga transkripti i datës 1 maj 2023 në faqet 1051, 1052

1 dhe më pas, në faqen 1067, ku, në faqen e fundit besoj,
2 dëshmitari ka deklaruar që të ndaluarit janë mbajtur në dhomë
3 si të dyshuar "për të verifikuar në qoftë se Serbia kishte
4 dërguar dikë për të mbledhur informacion të përgjithshëm ose
5 informacion inteligjent".

6 Mbase dhe një pikë tjetër të vogël do të doja të sqaroja.
7 Dëshmitari 1448 deklaroi lidhur me një femër të ndaluar aty
8 dhe nuk dua ta citoj sepse jemi në seancë të hapur, e cila
9 është marrë në pyetje sepse pretendohet që të kishte pasur
10 marrëdhënie me serbët. Ky dëshmitar thotë dhe dëshmia e këtij
11 dëshmitari konfirmohet nga Dëshmitari 4733, që, në fakt, kjo
12 gruaja që ishte e ndaluar është pyetur në qoftë se kishte
13 informacion lidhur me lidhjet e mundshme me të ndaluarit e
14 tjerë me serbët.

15 Pra, nuk dua të përmend asnjë emër ose asnjë informacion
16 identifikues lidhur me këto dy të ndaluar të tjerë, megjithatë
17 këto janë referencat që doja t'ju sillja në vëmendje.

18 Së fundi, lidhur me parashtimet e Prokurorisë që kanë të
19 bëjnë me rrethanat faktike të ndryshme në çështje.

20 Shumë shkurtimisht, dua të them që nga aspekti real
21 faktet janë tërësisht të ndryshme. Dhe në çështjen Celebici,
22 në fakt, bëhet fjalë për ndalimin e qindrave persona, pra, të
23 ndaluarve. Ndërkohë që rasti ynë është komplet ndryshe, pra,
24 në rastin Celebici bëhet fjalë për qindra të ndaluar dhe që
25 ishin të dyshuar që përbënin probleme sigurie dhe ky është një

1 faktor që tregon që ka pasur pretendime konkrete, ky është
2 parashtrimi ynë.

3 Ne jemi të lumtur që Prokuroria e ka marrë parashtrimin
4 tonë me seriozitet, pra, përkatësisht që Paneli duhet të
5 kishte konsideruar kohëzgjatjen e ndalimit. Dhe është kënaqësi
6 që e dëgjojmë këtë prej Prokurorisë sepse padiskutim që është
7 e rëndësishme që të ketë marrë parasysh edhe kohëzgjatja e
8 ndalimit, këto janë aspekte që dua të ishin marrë parasysh,
9 pavarësisht që ato nuk janë marrë.

10 Të nderuar Gjykatës, ju duhet t'i merrni parasysh këto.
11 Sepse aspekte të tilla, ne parashtrojmë, që do të ishte mirë
12 që të trajtoheshin në një rigjykim ose në gjykim të ri dhe që
13 zbatohet dhe që bën zbatimin korrekt të ligjit për ndalimin
14 arbitrar në konflikt jo ndërkombëtar.

15 Së fundi, sa i takon asaj çfarë u tha sot për dënimin nga
16 Prokuroria. Paragrafi i dytë i Nenit 7 ose pretendimet që
17 krimet dhe format e përgjegjësisë penale për të cilat është
18 dënuar z. Shala janë pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare
19 nuk ndryshojnë faktin që ia kemi bërë me dije dhe të cilat i
20 kemi reflektuar gjithashtu edhe në dosjen e apelit. E kam
21 konkretisht fjalën për paragrafin 256 dhe 260 të dosjes së
22 apelit. Është e nevojshme që të ketë një dënim që ka qenë e
23 aksesueshme, e qasshme dhe e parashikueshme në kohën kur është
24 kryer vepra në qoftë se ndonjë vepër. Kjo është e para.

25 Dhe, së dyti, dënimi sikurse është njohur nga Trupi

1 Gjykues, duhet që të jetë brenda gamës së viteve të dënimit të
2 parashikuara me ligj 5 deri në 15 vjet dhe jo aq sa ka dhënë
3 Trupi Gjykues, pra, 18 vjet.

4 Të nderuar Gjykatës, qëndrimi ynë është që kjo është një
5 shkelje e qartë e nenit 7. Faleminderit për vëmendjen.

6 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kam një pyetje për ju, znj.
7 Cariolou, për NKP I. Po të prezumojmë që këtu kemi rastin e
8 NKP I duke përfshirë këtu edhe vrasjen, siç është konfirmuar
9 nga Trupi Gjykues në aktgjykim, a nuk do ishte atëherë e
10 mjaftueshme nëse një anëtar i kësaj NKP-je, pra, NKP I, si i
11 akuzuari të ketë pasur qëllimin e përbashkët, përfshirë këtu
12 vrasjen, për ta ndaluar këtë person për vrasjen, domethënë, a
13 mendoni që është e drejtë që i akuzuari të dënohet për NKP I
14 dhe për synimin e përbashkët si pjesë e NKP I?

15 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Më jepni një çast për t'u
16 konsultuar, ju lutem.

17 [Mbrojtja këshillohet]

18 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shpresoj
19 t'i përgjigjem pyetjes tuaj, sipas nesh nuk mjafton. Duhet të
20 ketë synim të qartë për të vrarë viktimën në fjalë nga i
21 pandehuri konkret, për ne, duhet të ketë synim të qartë.

22 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Atëherë
24 pika e fundit në rendin e ditës për seancën e sotme është vetë
25 deklarata e z. Shala.

1 Z. Shala, fjala është për ju. Keni dhjetë minuta. Dhe po
2 rikujtoj çfarë thashë dhe dje, ju lutem, mos nxirrni
3 informacione konfidenciale gjatë deklaratës tuaj, në qoftë se
4 keni informacion konfidencial na thoni që të kalojmë në seancë
5 private. Z. Shala, fjala është për ju.

6 APELUESI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita, të nderuar
7 Gjyqtarë. Pa merak, rrini pa merak se nuk do merrem me ato që
8 i kanë marrë avokatët e mi me ato sa i përket informacioneve.

9 Unë vetëm prej dhjetë minutash nuk do t'i shfrytëzoj
10 dhjetë minutat. Po as pesë mendoj që jo.

11 Unë, pika e parë, mendoj që krejtësisht ç'ka është ndodhë
12 ndaj meje është një trillim komplet i paligjshëm dhe i
13 pasaktë. 18 viktimat, për 18 viktimat dënohem. Dhe prej 18
14 viktimave, të gjithë të gjallë, vjen vetëm një, një viktimë,
15 që e dini për kën është fjala dhe i dyti. Këta dy, njëni i
16 vdekur, tjetri i gjallë, që këta dy japin dëshmi dhe këto janë
17 të besueshme.

18 Ju paralajmëroj se këta dy, këta dy viktimat, që e dini
19 për kën është fjala, kanë qenë [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 Dhe tani [REDAKTUAR] ra poshtë. Si mund të
23 jenë të besueshëm këta që Prokuroria mbështetet vetëm tek këta
24 kur të gjithë e dinë se këta kanë qenë aty?

25 Dhe kaq kam për të thënë unë.

1 Ju lutem, të nderuar Gjyqtarë, unë nuk kërkoj mëshirë, po
2 vetëm kërkoj drejtësi. Ma jepni drejtësinë që më përket. Nuk
3 kam të bëj me vrasje. Nuk kam ken në dijeni tek në vitin 2015
4 kur më kanë telefonue. E si paskam pas qëllim për ta vra kur
5 s'kam qenë as në dijeni?

6 Dhe këtë mund e vërteton edhe e tha edhe Avokati i
7 Viktimave që tha [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]
9 [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR] por nuk jam kanë në
11 dijeni. Dhe ai, zotnia ka përfitu do rasti që pretendohet që e
12 ka bë, që nuk jam në dijeni unë, po do rasti që e ka bë, ai e
13 [REDAKTUAR]
14 [REDAKTUAR]
15 [REDAKTUAR].

16 [REDAKTUAR], aty e kam
17 kuptu se [REDAKTUAR]
18 [REDAKTUAR]. Unë s'kam dit as çka ka bëhet.

19 [REDAKTUAR]. Shifja
20 mirësjelljen e tijna [REDAKTUAR] dhe kush është
21 personi.

22 Dhe, normal, unë vetëm kërkoj drejtësi. Jam i pafajshëm.
23 I pafajshëm. I pafajshëm për çka më akuzoni. Nuk pretendoj se
24 jam engjëll, po për qëta çka më akuzoni as fare dijeni tekna

1 ditën e arrestimit as nuk kam pas dijeni se çka ka ndodh, le
2 më kam përgjegjësi.

3 Unë ju falënderoj. Ju lutem ma jepni drejtësinë që më
4 përket, jo, as më shumë as më pak. Ju falënderoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

6 Faleminderit, z. Shala.

7 Me kaq e mbyllim seancën e apelit. Përpara se të
8 përfundojmë, dëshiroj të shfrytëzoj këtë mundësi për të
9 falënderuar palët, pjesëmarrësit, Zyrën Administrative për
10 punën e kryer dhe për gjithë personat që na ndoqën. Edhe
11 falënderoj edhe përkthyesit, stenografin edhe të gjithë
12 personat e tjerë që na ndihmuan për këtë seancë dhe për punën
13 e tyre të shkëlqyer.

14 Ne do ta lëshojmë aktgjykimin lidhur me apelin e z. Shala
15 kundër Trupit Gjykses I në kohën e parashikuar.

16 Seanca mbyllet këtu.

17 --- Seanca mbyllet në orën 13.00

18

19

20

21

22

23

24

25